

## INTERVISTA

# Lifter Maliqi: Si ia dogja PD-së mandatin e dytë në Berat

'Basha mashtron për çdo gjë, më tha se do të bëhesha deputet në vend të Eduard Halimit'

ADRIATIK DOÇI

► FAQE 4



## INTERVISTA

# Peleshi: Ja si do të rristrukturohet qeveria dhe administrata

Flet kryetari i grupit të punës për reformimin: Duam të ndërtojmë një arkitekturë të re

ESIONA KONOMI

► FAQE 7



# SHQIPTARJA.COM

Lexoni  
Dëgjoni  
Shikoni  
EDICIONI MULTIMEDIAL



Kjo gazetë përdor teknologjinë QR-CODE

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VII - NR. 162

E MËRKURË, 12-07-2017

www.shqiptarja.com



## BANDAT E DROGËS I DENUAR ME 20 VJET NE ITALI, GJYKATA E DURRESIT LIRON "BARONIN"

Policia e kishte arrestuar 3 ditë më parë në qytetin bregdetar. Gjykata: E kreu dënimin në Shqipëri

ELTON QYNO

► FAQE 14



# Koalicion i ri?

# LSI FTON BASHEN DHE IDRIZIN PER T'U BASHKUAR KUNDER RAMES

**Monika Kryemadhi: Të krijojmë një front kombëtar opozitar pa dallime ideologjike**

20.000 numëruesit e PD-PR nxjerrin bllof Berishën, asnjë pretendim për tjetërsim votash në zgjedhje

ADRIATIK DOÇI

► FAQE 2-3



## KËSTI I TETË

# Ish-të përndjekurit, 490 përfituesit që kanë marrë lekët

Financat: Në shumë raste mungojnë certifikata personale ose llogaria bankare s'është aktive

DRIÇIM ÇAKA

► FAQE 12-13

## Koalicioni i ri

# LSI fton Bashën dhe Idrizin për t'u bashkuar kundër Ramës

## Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi: Të krijojmë një fron kombëtar opozitar pa dallime ideologjike

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

Qeveria 'Rama 2' duket se do të përballet me një opozitë të fortë. Lëvizja Socialiste për Integrim, vetëm dy javë pas humbjes së zgjedhjeve, kërkon bashkëpunim me Partinë Demokratike dhe PDIU kundër Partisë Socialiste, me të cilën qeverisi katër vite dhe si për ironi vijon ende të qeverisë. LSI nuk e fsheh synimin për krijimin e një koalicioni me të gjithë faktorët politikë opozitar kundër socialistëve në pushtet. Kryetarja e re e LSI-së znj. Monika Kryemadhi, në mbledhjen e kryesisë së kësaj partie, kërkoi krijimin e një fronti kombëtar opozitar kundër Partisë Socialiste, të cilës shqiptarët i besuan qeverisjen e vendit. Ideja për krijimin e një fronti opozitar nga zonja Kryemadhi, pa dallime ideologjike, është një ftesë e qartë për Partinë Demokratike dhe PDIU, për t'u bashkuar kundër Edi Ramës. Duke i konsideruar zgjedhjet të manipuluar, Kryemadhi tha se bashkimi është i domosdoshëm pasi sipas saj fatet e demokracisë janë më në udhëkryq se asnjëherë tjetër. "Fatet e demokracisë janë më në udhëkryq se asnjëherë tjetër, dhe kjo kërkon krijimin e një fronti kombëtar opozitar, pa dallime ideologjike pasi themeli i demokracisë, vota e lirë, është goditur rëndë në mënyrë të strukturuar kriminale dhe epidemike në të gjithë vendin. Ndaj kërkoj nga të gjithë ju angazhimin tuaj maksimal dhe të gjithë anëtarëve të LSI-së dhe mbështetëseve të saj për t'u përgjigjur këtij momenti dhe përgjegjësisë politike më të madhe që LSI ka pasur ndonjëherë. Do të vazhdojmë me evidentimin e farsës së 25 qershorit, me fakte dhe dokumente të shumta të manipulimit, të dhunës policore dhe bandave kriminale, që shkaktuan deformimin e rëndë të votës së shqiptarëve në këto 25 vjet", tha Kryemadhi. Po gjatë ditës së djeshme, Kryemadhi ka mbështetur pretendimet e PDIU për mandatin në Tiranë, ndërsa Lulzim Basha ka shprehur pendesë për marrëveshjen me Ramën.

### BASHKËPUNIMI

Në kuadër të ftesës, Kryemadhi tha se LSI do të

### Derbati

## Luan Rama: LRI organizon kampingun në Jalë

Zëvendëskryetari i LSI Luan Rama tha dje se YUSI dhe LSI organizojnë kampingun në Jalë. "Duke e patur si prioritet të parë zhvillimin në ditët e ardhshme të kampingut të Jalës, të kësaj veprimtarie tashmë të kthyer në një institucion të formimit politik dhe të krijimit të shkollës së debatit dhe ballafaqimi të alternativave midis të rinjve çka është në fakt dhe një prej vlerave më thelbësore të LSI-së. Në fund të kësaj jave për herë të parë në Shqipëri, në Jalë konkretisht, do të zhvillohet një kamping i organizuar nga YUSI, Internacionalja e të Rinjve Socialist, me Lëvizjen Rinore për Integrim çka është një ridimensionim tjetër i rolit dhe i veprimtarisë shumë efektive dhe si një protagoniste me rekorde shumë pozitive në përbërje të organizimeve ndërkombëtare të rinisë, nga ana e Lëvizjes Rinore për Integrim", tha ai.

### Kampi

## FRESH kundër LSI: Nuk e organizoni ju

Pas prishjes së koalicionit qeverisës PS-LSI, FRESH dhe LRI janë "përplasur" për kampin veror në Jalë. Dje, Luan Rama në një deklaratë për mediat u shpreh se LSI do të vijojë edhe këtë vit me kampingun e Jalës. Por FRESH përmes një deklaratë thotë se kampingu këtë vit nuk organizohet nga LRI, por nga të rinjtë e Internacionales Socialiste. FRESH i kërkon kryesisë së LSI- të distancohet nga deklaratat e fundit dhe mënyra e politikëbërjes dhe të lejojë të rinjtë e LRI që të marrin pjesë. "FRESH dhe organizatorët e Internacionales Socialiste të të Rinjve shprehin keqardhje për mënyrën se si strukturat e LSI-së po keqinformojnë dhe manipulojnë opinionin publik, në lidhje me kampin që organizon Internacionalja Socialiste e të Rinjve (IUSY) në Jalë", thuhet në deklaratë.

### Internacionalja

## Eventi mbahet nga LRI, mbështetet nga FRESH

Internacionalja e të Rinjve Socialistë ka reaguar pas përplasjes me LRI-së dhe FRESH-it në lidhje me 110-vjetorin e themelimit në Shqipëri të IUSYt. Internacionalja thotë se eventin organizohet nga LRI, por mbështetet nga FRESH. "Internacionalja e të Rinjve Socialistë, organizata politike rinore më e madhe në botë, do të festojë përvjetorin e 110 të krijimit në Jalë, Shqipëri, në datat 15-20 Korrik, në lidhje me Festivalin Botëror të IUSYt 2017, me temë "Ne nuk shohim kufi". Eventin mbahet nga LRI dhe mbështetet nga FRESH dhe Partia Evropiane Socialiste. Ky Festival do të presë më shumë se 1000 pjesëmarrës nga e gjithë bota, përfaqësues të 60 shteteve dhe 90 organizata", thuhet në deklaratë.

### BASHKËPUNIMI

"Ne do të bashkëpunojmë me të gjithë faktorët politik dhe qytetar për përmbushjen e këtij misioni. Kjo është edhe një nga detyrat kryesore që ne do të kemi deri në procesin e fundit dhe gjithashtu do të vazhdojmë edhe me hartimin e axhendës dhe planit të punës".



bashkëpunojë me të gjithë faktorët politikë. "Kjo detyrë tashmë do të mbetet një prioritet pasi opinioni minutë pas minute po njihet me fakte të reja dhe tronditëse të grabitjes dhe të tjetërsimit të votës së zgjedhjeve të 25 qershorit. Ne do të bashkëpunojmë me të gjithë faktorët politik dhe qytetar për përmbushjen e këtij misioni. Kjo është edhe një nga detyrat kryesore që ne do të kemi deri në procesin e fundit dhe gjithashtu do të vazhdojmë edhe me hartimin e axhendës dhe planit të punës deri në periudhën e fillimit të legjislaturës së re parlamentare", nënvizoi Monika Kryemadhi.

### OPOZITË E FORTË

Kryemadhi theksoi gjithashtu se LSI do të rivendosë sovranitetin e institucioneve të cenuara rëndë nga zgjedhjet, përpara dhe pas 25 qershorit pasi demokracia në vend sot ka nevojë më shumë se kurrë për një opozitë më të fuqishme se asnjëherë tjetër. "Si kryetare e LSI-së duke shprehur edhe një herë

### LSI:

## U konfirmua ajo që denoncua, vjedhja e votave

Në përfundim të mbledhjes të kryesisë së LSI-së, zëvendëskryetari Luan Rama u shpreh se kjo forcë politike e kanë vënë theksin te krijimi i një fronti kombëtar opozitar. Rama dhe një mesazh politik në përfundim të mbledhjes së kryesisë së kësaj partie, për mënyrën e mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme. Sipas tij, u konfirmua ajo që denoncoi LSI, vjedhja skandalozë e votave, për të cilën thotë se duhet të ngrihet një front opozitar.



falënderimin për besimin dhe përkrahjen që më dhatë për të qenë në krye të LSI-së, dua t'ju falënderoj edhe juve si bashkëpunëtor dhe të gjithë kryesinë aktuale dhe të gjitha forumet e LSI-së në të gjithë vendin për kontributin që kanë dhënë për rritjen e pandalshme të forcës tonë politike. Dua t'ju siguroj se së bashku, LSI do të vazhdojë të njoh arritje të reja politike dhe elektorale si domosdoshmëri që demokracia në Shqipëri të fuqizohet dhe qytetarët shqiptar të rivendosin sa më parë të jetë e mundur sovranitetin mbi qeverisjen dhe institucionet të cenuara rëndë nga zgjedhjet, përpara dhe pas 25 qershorit. Kushtet e reja më imponuan që të pranoj ketë përgjegjësi, e shqetësuar jo vetëm për fatin e LSI-së, por për demokracinë në vend e cila sot ka nevojë më shumë se kurrë për një opozitë më të fuqishme se asnjëherë tjetër, sepse mazhoranca e dalë nga zgjedhjet e 25 qershorit është një mazhorancë fiktive përmes një procesi të deformuar dhe të manipuluar", tha kryetarja e LSI-së.



## Pretendimi i Berishës për zgjedhjet

Vjedhjen e mandatit të PDIU nga Noriega në Qarkun e Tiranës. Ai thotë se disponon 19 video për vjedhjen skandaloze të mandateve nga kanibalët e votave të Edvin Kristaq Ramës. I bëj thirrje KQZ të rinumërojë nga e para votat për Qarkun e Tiranës dhe për çdo qark tjetër ku ekzistojnë të dhëna për vjedhje të votave. I bëj thirrje prokurorisë së shtetit të ndëshkojë me forcën e ligjit kriminelet e votës së shqiptarëve. Lexoni ju lutem mesazhin dhe shikoni videon skandaloze që ka dërguar qytetari dixhital! “Përshëndetje doktor, kjo është vetëm një prej shumë videove që kemi gjetur nga regjistrimet e kamerave ku shihet se si PS ka tjetërsuar votën e PDIU gjatë numërimit. Kemi gjetur skandale të tjera dhe më të mëdha se kaq, janë plot 19 video të tjera me akte të dhunimit të votës gjatë procesit të numërimit”.

## Kreu i KQZ-së mesazh për prokurorinë

Kryetari i KQZ, Klement Zguri, i ka kërkuar prokurorisë të dalë me një rezultat për procedimet penale në fushën e zgjedhjeve. “Shqiptarët presin të bëhet publik sa më shpejt rezultati i procedimeve penale për të gjitha veprat penale në fushën e zgjedhjeve që janë në hetim. Qytetarët kanë nevojë ta shohin drejtësinë penale në fushën e zgjedhjeve në veprim dhe në lartësinë e ligjit. Pa lajme serioze, të besueshme dhe të qëndrueshme nga organet e ndjekjes penale nuk mund të ringrihet besimi i publikut tek zgjedhjet. Për këtë arsye, u bëj thirrje të gjitha institucioneve të përfshira të përmbyllin me përparësi procedurat e tyre të hetimit administrativ apo penal dhe të bëjnë sa më shpejt publike rezultatet e punës së tyre. Veprimtaria efikase e tyre është vendimtare për parandalimin e ngjarjeve apo fenomeneve të shkeljes së ligjit në fushën e zgjedhjeve në të ardhmen, është faktor i pazëvendësueshëm për rritjen e cilësisë së zgjedhjeve në Shqipëri”, tha Zguri.



## Bie alibia



ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

# 20 mijë komisionerë të PD rrëzojnë Berishën

## Mbyllen ankesat për zgjedhjet, numëruesit e PD-PR asnjë pretendim për tjetërsimin e votave, hedhin poshtë alibinë e Sali Berishës

Mbyllen ankimet për zgjedhjet e 25 Qershorit. Mbi 20 mijë komisionerë të Partisë Demokratike dhe Partisë Republikane, në të gjitha komisionet e administrimit të zgjedhjeve parlamentare të 25 Qershorit 2017, hedhin poshtë alibinë ish-kryeministrit Sali Berisha dhe pasardhësit të tij politik, Lulzim Basha, për tjetërsimin e votës së qytetarëve shqiptarë. Të besuarit e opozitës në qendrat e votimit dhe grupet e numërimit të votave nuk konfirmojnë asnjë pretendim të humbësve të zgjedhjeve, për tjetërsimin e votave, sidomos gjatë procesit të numërimit. Dy javë pas disfatës më të rëndë në karrierën e tyre politike, Sali Berisha dhe Lulzim Basha, po tentojnë të justifikojnë humbjen në sytë e demokratëve, duke ndërtuar një alibi për humbjen e radhës, të shtatën që nga zgjedhjet lokale të 2011. Berisha ka kërkuar hapjen e kutive të votimit në Qarkun e Tiranës dhe në të gjitha qarqet e tjera, me pretendimin se votat janë tjetërsuar gjatë procesit të numërimit. Ndërsa Lulzim Basha shkon edhe më tej, teksa thotë se votat janë blerë para se Partia Demokratike të niste fushatën. Pretendime të tilla, sidomos ai i Berishës, mbështeten edhe nga Lëvizja Socialiste për Integrim dhe PDIU, të cilat së bashku me PD do të jenë gjithashtu në opozitë për katër vitet e ardhshme. Por, akuzat për vjedhje të votave duket se konsistojnë thjeshtë në strategjinë e re politike dhe në funksion të qetësisë të turbullirave të



## → RRËZOHET ALIBIA

Mbi 20 mijë komisionerë të Partisë Demokratike hedhin poshtë alibinë ish-kryeministrit Sali Berisha, për tjetërsimin e votës së qytetarëve shqiptarë, gjatë procesit të numërimit të votave.

brendshme në parti, pasi pretendime të tilla nuk reflektohen në shënimet e komisionerëve të Partisë Demokratike apo edhe të LSI. Anëtarët e grupeve të numërimit të PD-PR dhe përfaqësuesit e tyre në KZAZ e përkatëse, nuk kanë shënuar asnjë pasaktësi në procesverbalet e konstatimit për procesin e numërimit të votave. Në kushtet kur disa përfaqësues të PD kanë hedhur dyshime për blerjen e numëruesve të tyre, puna korrekte e numëruesve të opozitës konfirmohet edhe nga vëzhguesit e Partisë Demokratike, të cilët nuk kanë njoftuar për asnjë mospërputhje apo

parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave apo edhe procesit të votimit. Numërimi i votave në përputhje me ligjin është reflektuar edhe në numrin e paktët të ankesave të subjekteve zgjedhore për rezultatit e zgjedhjeve.

## PD VETËM NJË ANKESË

Pavarësisht pretendimeve të Sali Berishës dhe Lulzim Bashës për manipulimin e zgjedhjeve, Partia Demokratike ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vetëm një ankesë, ku konteston tabelën përmblledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për Qarkun

e ankimit po në KQZ kundër vendimeve për secilin qark. Subjektet kishin të drejtën të kërkonin ndryshimin e Tabelave Përmblledhëse të Rezultatit sipas qarqeve ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo më shumë qendra votimi. Këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, e cila ka kontestuar tabelën përmblledhëse të rezultatit për Qarkun Tiranë, Partia Demokratike, e cila ka kontestuar tabelën përmblledhëse të rezultatit për Qarkun Berat, si dhe Partia Socialiste e cila ka kontestuar tabelën përmblledhëse të rezultatit për Qarkun Tiranë. Tabelat përmblledhëse të rezultateve për qarqet e tjera, nga sot nuk mund të kontestohen më”, tha Zguri. Ai shtoi se asnjë subjekt elektorale nuk ka paraqitur kërkesë për deklarimin e pavlefshëm të rezultatit në ndonjë qendër votimi. “Kërkesa të tilla, nga sot nuk mund të depozitohen më. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do procedojë me shqyrtimin e këtyre kërkesave ankimore, përpara se të përmbyllë këtë fazë të procedurave të veta administrative. Afati ligjor i përcaktuar për këtë fundit do të KQZ-së për miratimin e Tabelave Përmblledhëse të Rezultatit. Subjektet zgjedhore deri dje kanë pasur të drejtën

Berat. Përfaqësuesit ligjorë të PD nuk kanë ngritur asnjë pretendim tjetër në asnjë qark tjetër të vendit. Lajmi është konfirmuar nga vetë kryetari i KQZ, Klement Zguri, i cili njoftoi edhe fundin e afatit për të kontestuar rezultatit e zgjedhjeve. Ndërkaq, tezës së manipulimit të votave nuk i besojnë as 100 funksionarë të lartë të Partisë Demokratike, të cilët kanë identifikuar Lulzim Bashën dhe rrethin e tij si përgjegjës për humbjen.

## SKADON AFATI PËR ANKESAT

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Klement Zguri, deklaroi dje se tabelat përmblledhëse të rezultatit të zgjedhjeve nuk mund të kontestohen më. “Ditën e hënë u mbushën 5 ditë nga shpallja e vendimit të fundit të KQZ-së për miratimin e Tabelave Përmblledhëse të Rezultatit. Subjektet zgjedhore deri dje kanë pasur të drejtën

## Ankesa

Pavarësisht pretendimeve të Sali Berishës dhe Lulzim Bashës për manipulimin e zgjedhjeve, Partia Demokratike ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vetëm një ankesë, ku konteston tabelën përmblledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për Qarkun Berat.



vëmendjen për një çështje tjetër tejet të rëndësishme. Shqyrtimi administrativ i ankimeve nga KQZ-ja nuk ezauron gjithë problematikën e këtyre zgjedhjeve. Procesi, me gjasë, do investojë dhe Kolegjin Zgjedhor, tek drejtësia e të cilit KQZ mbështetet plot besim. Por procesi ka regjistruar incidente dhe shkelje të natyrave të tjera, të cilat kërkojnë reagimin e përgjegjshëm edhe të institucioneve të tjera. Task Forca e ngritur nga Këshilli i Ministrave për monitorimin e Zgjedhjeve 2017 apo Departamenti i Administratës Publike, janë marrë gjerësisht me problematikën e zgjedhjeve, kanë bërë konstatime, kanë ndërhyrë dhe kanë nisur procedura hetimi administrativ. Është momenti që këto organizma të bëjnë publike rezultatet e punës së tyre”, pohoi kreu i KQZ.

## FAZA TJETËR

Zguri tha se për tre ankesat e PS, PD dhe PDIU fjalën e fundit do ta ketë Kolegji Zgjedhor. “Përfitoj nga ky komunikim publik, për të tërhequr

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Lefter Maliqi, gjatë një interviste për Shqiptarja.com, thotë se ka kontribuar për t'i hequr PD mandatin e dytë në Qarkun e Beratit, pas përplasjes me Lulzim Bashën, i cili e vuri të tretin në listë në këtë qark. Maliqi theksoi se Partia Demokratike ka marrë vetëm 19 % të votave në Berat, duke shënuar humbjen më të thellë në historinë e saj. Ish-deputeti i PD ka folur edhe rreth ofertave të Lulzim Bashës pas deklaratës se do të tërhiqej nga lista e PD dhe se do të mbështeste Partinë Socialiste. Sipas tij, Basha i kishte premtuar se do të bëhej deputet në vend të Eduard Halimit, pasi Halimi, sipas Bashës, do të bëhej ministër. Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Lefter Maliqi, ka folur gjithashtu mbi prapaskenat e hartimit të listës së kandidatëve për deputetë të PD si dhe për komunikimet me Berishën, Bashën, Ramën dhe me grupin kundërshtar të Bashës brenda PD.

**-Z. Maliqi, ju refuzuat të renditeshit i treti në listën e kandidatëve për deputetë të Partisë Demokratike në Berat, ndërsa u deklaruat publikisht kundër Lulzim Bashës dhe në mbështetje të Edi Ramës. Ku konsistoi kontributi juaj në rezultatin negativ të PD në Berat? Kontributi im ishte se iu dogji mandati**

# Lefter Maliqi: Si ia dogja PD-së mandatin e dytë në Berat

## 'Basha mashtron për çdo gjë, më tha se do të bëhesha deputet në vend të Eduard Halimit'

thellë me 4 mandate dhe duke rrezikuar për pak vota mandatin e 5-të për PS.

**-Keni pasur raporte të tensionuara me Lulzim Bashën, sidomos pas publikimit të listës. Çfarë pakti keni pasur me Bashën? Çfarë ju premtoi ai?**

Sa i përket raporteve personale me Bashën, unë qëndrova besnik deri në momentin e shpalljes së listës. Nëse unë do të doja që të ikja me forca të tjera politike, do të isha i sigurt në listë që dy muaj përpara. Por i besova fjalë së Bashës, i cili më ka mashtruar mbi katër herë. Më premtoi për të konkurruar për kryetarin e Bashkisë së Beratit. Në 2015 do të fitoja bindshëm përballë kandidatit të LSI. Pabesisht, më thotë se Beratit ia kemi lënë Partisë Republikane. Më pas më premtoi se do të isha i pari në listën e PD për Beratin. Unë vazhdova punën. Isha bashkë me z. Bode. Ridvan Bode ishte i deleguar dhe mbulonte qytetin, ndërsa unë zonat rurale. Mendova se Bode do të ishte i pari, ndërsa unë i dyti. Do të pranoja edhe të dytin. Për premtimin e vura edhe në dijeni edhe z. Berisha. Berishës i jam mirënjohës. Por, ku mora vesh në orën 01:30 të natës se unë isha i treti, u kam dërguar mesazh të dyve, edhe Berishës, edhe Bashës, se isha i fyer nga kjo pabesi.

**-Cili ishte reagimi i Berishës?**

Sali Berisha më ktheu përgjigje dhe më tha se vlerësonte punën time, por lista është hartuar nga Lulzim Basha dhe se kishte bërë të pamundurën për mua. Ndërsa Basha, pasi e kam takuar më bëri oferta të çuditshme.

**-Ju mendoni se Berisha nuk ka dorë në hartimin e listës?**

Unë nuk mund ta them këtë gjë. Unë di vetëm që Lulzim Basha gënjen. Më kanë thënë shumë vota, që kanë pasur eksperiencën me të, se ai gënjen. Nga të gjitha të dhënat, nga komunikimi me shumë njerëz, thonë se Basha e ka bërë vetë listën. Unë jam takuar edhe me z. Topalli, me Patozin, Imamin, Rulin etj., me të gjitha këta të



### Për Bashën

"Basha nuk e sjellë kurrë PD në pushtet. Nuk përcjell shpresë dhe optimizëm. Gënjen dhe mashtron për çdo gjë. Nuk di që të drejtojë. Nuk e mban fjalën. E ka kthyer PD në një parti familjare. Kjo garë është farsë dhe do ta çojë PD në dështime të tjera fatale".



### Për Berishën

"Sali Berisha më ktheu përgjigje dhe më tha se vlerësonte punën time, por lista është hartuar nga Lulzim Basha dhe se kishte bërë të pamundurën për mua. Ndërsa Basha, pasi e kam takuar më bëri oferta të çuditshme".



përjashtuarit, për të ditur të vërtetën e listës. Këta mendonin se Basha e ka bërë listën vetëm me familjen e tij, kunati dhe njerëzit e tjerë të afërt. Edi Rama



ka lindur me këmishë sepse në Shqipëri nuk ka më opozitë. I pata thënë se do të merrte mbi 71 mandate. Kjo opozitë është e shkatërruar, nuk ka drejtim, është e çorganizuar totalisht. Nuk mund ta marrë më veten. Në zgjedhjet e ardhshme do të humbasë më thellë.

**-Thatë se Basha u ka bërë oferta të çuditshme. Konkretisht, të çfarë natyre ishin ofertat?**

Oferta e Bashës ishte se Eduard Halimi do të bëhej ministër dhe se unë do të bëhesha deputet në vend të tij. Tha se kishte qenë në një pozicion shumë të vështirë dhe se i bënin shion të vjetrit. Unë e paralajmërova Bashën se Partia Demokratike, me këtë listë, nuk do ta merrte mandatin e dytë në Berat. Por ai kishte një eufori se do t'i fitonte zgjedhjet me këtë listë. Në këto kushte, duke pyetur edhe elektoratin vendosa që të ikja tek Partia Socialiste. Pasi kam bërë deklaratën, kam pasur një telefonatë nga kryeministri Edi Rama, i cili më falënderoi. Unë i thash se nuk kërkoj asgjë, por vetëm disa investime në zonën time. Gjithashtu, i kam garantuar z. Rama se unë do të digjia mandatin e dytë të Partisë Demokratike në Berat. Tashmë, Partia Demokratike do mbi 10 vjet që të marrë vetën në Berat. Me këtë trend, në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, në Berat do të rrezikohet edhe mandati i parë i Partisë Demokratike.

**-Megjithatë, mënyra e hartimit dhe përbërja e listës nuk mund të jetë arsyeja e vetme e humbjes...**

Edhe ajo çadra që ngriti në bulevard ishte një farsë. Na lodhi dhe në torturoi për tre muaj dhe më në fund shkoi e bëri një marrëveshje për interesat e veta. Partia Demokratike tani nuk ka një lider. Duke mos pasur një lider, nuk ka frymëzim. Duke mos pasur frymëzim, nuk ka shpresë. Duke mos pasur shpresë, nuk mund të ketë fitore në zgjedhje. Është lideri ai që frymëzon. PD i mungon lideri. Me këtë kryetar, i cili sipas të gjitha gjasave do të zgjidhet sërish, PD do të ketë një humbje edhe më të madhe në zgjedhjet lokale.

**-Si e vlerësoni garën për kreun e PD?**

Basha nuk e sjellë kurrë PD në pushtet. Nuk përcjell shpresë dhe optimizëm. Gënjen dhe mashtron për çdo gjë. Nuk di që të drejtojë. Nuk e mban fjalën. E ka kthyer PD në një parti familjare. Kjo garë është farsë dhe do ta çojë PD në dështime të tjera fatale.

**NË FOTO:**  
Lefter Maliqi,  
ish-deputeti  
i Partisë  
Demokratike



**Maliqi**  
"Kontributi im ishte se iu dogji mandati i dytë i Partisë Demokratike, ndërsa Partia Socialiste mori mandatin e katërt. Po ashtu, Partia Demokratike ka pësuar rënie me 7 mijë vota krahasuar me zgjedhjet e 2013. Pata një mbështetje masive nga qytetarët".



## HUMBJA / KREU I PD NUK NJEH ZGJEDHJET

# Lulzim Basha: Qeveria e re nuk është legjitime

Lulzim Basha, në kuadër të planit për t'u rikonfirmuar në krye të PD, vijon turin e takimeve me demokratët e Tiranës në zonën e Vorës, Kombinatit, Kasharit, Dajtit e Farkës. Basha tha se mazhoranca e zgjedhjeve të 25 Qershorit është fiktive dhe reflekton vetëm shitblerjen masive të votës së shqiptareve dhe si e tillë nuk do mund të qeverisë. "E vetmja forcë politike që nuk u angazhua në këtë proces imoral ishte Partia Demokratike. E vetmja forcë politike që u ofroi një alternativë shqiptarëve ishim ne. Kjo që ka dalë nga këto zgjedhje është një mazhorancë fiktive që reflekton vetëm shtrembërimin

### → BASHA

"Kjo që ka dalë nga këto zgjedhje është një mazhorancë fiktive që reflekton vetëm shtrembërimin e votës. Kjo që ka dalë nga këto zgjedhje kurrsesi s'mund të jetë një qeveri legjitime dhe nuk ka shansin të qeverisë në mënyrë legjitime dhe të drejtë".

e votës. Kjo që ka dalë nga këto zgjedhje kurrsesi s'mund të jetë një qeveri legjitime dhe nuk ka shansin të qeverisë në mënyrë legjitime dhe të drejtë. Jo vetëm sepse vjen me një deficit demokratik pa votën e vërtetë të qytetarëve, pa vullnetin e vërtetë të qytetarëve, por se ardhja pa plan e pa vizion po duket që këto orë, ditë e javë të

para. E keni parë që s'kanë para të paguajnë rrogat e mësuesve. Ekonomia është në kolaps, këta nuk kanë zgjidhje. Financat publike janë në kolaps, këta nuk kanë zgjidhje", tha Basha. Ndonëse 18 Maji legjitimoi kauzën e zgjedhjeve të lira, tha Basha, Edi Rama minoi terrenin elektoral me projektin e tij politik për të blerë votën e shqiptare

duke përdorur paratë e drogës, korrupsionin e parave publike dhe bandat. "Përkulem me respektin më të thellë, me mirënjohje time të përjetshme për sakrificën tuaj në Çadrën e Lirisë për 90 ditë e 90 net me radhë, e cila u dha shqiptarëve jo vetëm kauzë e drejtë për zgjedhje të lira por edhe shpresën për një të nesërme ndryshe. Një raport tjetër midis qeverisë dhe qytetarit. Dhe ky është pikërisht programi i Partisë Demokratike. Ky është programi ynë, një qeveri për qytetarët. Ne e dinim se çfarë gatuhej nga qeveria që erdhi në pushtet me ndihmën e kimit. Droga që mbuloi Shqipërinë ishte dhe është një projekt politik i Partisë Socialiste dhe Edi Ramës. Por siç e dimë fare mirë, ndonëse 18 Maji legjitimoi kauzën tonë të drejtë para çdo shqiptari dhe para komunitetit ndërkombëtar, nuk arriti as ta frenojë dhe as ta shkatërojë mekanizmin që ishte vënë në lëvizje. Këtë e dini fare mirë ju. E dinë gjithë demokratët, e dinë gjithë qytetarët. E di unë, e di i madh dhe i vogël se me çfarë u përballëm që javën e parë pas kësaj marrëveshje politike", tha Basha.

# Rebelohen degët e PD-së, kërkojnë anulimin e zgjedhjeve

Pas Korçës edhe demokratët e Vlorës petition kundër zgjedhjeve në 22 korrik, Patozi nis sot lëvizjen kundër Bashës

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

Lëkundjen pozitë e Lulzim Bashës dhe të mbështetës të tij në prapaskenë, Sali Berishës, në Partinë Demokratike. Lëvizja anti-Basha në Partinë Demokratike, e iniciuar nga një grup funksionarësh të lartë të PD, duket se po merr karakter kombëtar. Këmbëngulja e Lulzim Bashës dhe Sali Berishës për të zhvilluar zgjedhjet për kreun e PD në 22 korrik, duke hedhur poshtë kërkesat e grupit kundërshtar, në vend që ta bashkojë, duket se do ta përçajë PD. Pas degës së Partisë Demokratike në Korçë, edhe demokratët e Vlorës janë kundër mënyrës si po bëhen zgjedhjet në Partinë Demokratike. Përmes një peticioni, demokratët e Vlorës, kërkojnë anulimin e zgjedhjeve dhe mbledhjen e Këshillit Kombëtar. Dega lokale e PD në qytetin bregdetar ka firmosur një peticion, ku shprehet se aktet e nxjerra nga Lulzim Basha dhe delegimi i funksioneve është kundër rregullores së parashikuar në statut. Peticioni është firmosur nga 150 demokratë, një ditë para se Lulzim Basha të mbërrijë në qytetin e Vlorës, për të zhvilluar fushatën brenda partisë, për një mandat të dytë. Ndërkaq, ditën e hënë, 130 anëtarë të degës së Partisë Demokratike të Korçës kërkuar anulimin e procedurës për zgjedhjen e kryetarit të PD-së, nëpërmjet një peticioni, pasi e cilësojnë garën farsë. Pozicionimi i degëve të Partisë Demokratike kundër zgjedhjeve të 22 kor-



### Iglij Cara:

## Basha më keq se Enver Hoxha, nuk e quaj kryetar

Partisë Demokratike, Iglij Cara, në një intervistë për emisionin "Fol me mua", ka qenë mjaft i ashpër me Lulzim Bashën, ndërsa shprehet se edhe Enver Hoxha vendimet e rëndësishme i merrte me njerëz të afërt dhe asnjëherë vetëm sikur bëri Basha me listat. "Pse duhen fshehur listat. Ne jemi parti legale, nuk jemi parti komuniste. Berisha e ka mbledhur gjithmonë kryesinë sa herë ka pasur lista. Kam përshtypjen që Enver Hoxha dhe Nexhmija nuk i bënë listat vetëm pa pasur një konsultë", deklaroi ai. Iglij Cara i zgjedhur në 2013 në qarkun e Durrësit si deputet i PD u la jashtë nga lista Basha në zgjedhjet e 25 qershorit. "Nëse do të kishte një garë të ndershme, unë i pari do të thosha: T'i fitove unë do të jem ushtari i partisë tënde. Por unë refuzoj që këto t'i quaj zgjedhje. Refuzoj ta quaj kryetar pas këtyre zgjedhjeve farsë", tha ai.


rikut i paraprin një lëvizje të grupit kundërshtar të Lulzim Bashës, i cili do të nisë një tur takimesh në bazë, për anulimin e zgjedhjeve, dorëheqjen e Bashës dhe organizimin e një tjetër procesi, të barabartë dhe sipas rregullave që parashikon statuti. Në ditën në vijim,

pritet që degë të tjera të Partisë Demokratike të firmosin peticione kundër zgjedhjeve me 22 korrik. Po ashtu, gara është kundërshtuar edhe nga mbi 100 funksionarë të lartë të Partisë Demokratike, duke e konsideruar një farsë. Nga ana tjetër, në lëvizje është vënë

edhe Sali Berisha, i cili po lëviz çdo gurë në prapaskenë për të zbutur krizën.

### PATOZI NIS LËVIZJEN NË PD

Ashtu sikur paralajmëroi të hënë në emisionin '5 Pyetjet nga Babaramo', Astrit Patozi ka nisur lëvizjen brenda PD për të kundërshtuar zgjedhjet në parti. Ditën e mërkurë, ora 19:00, ai do të organizojë një takim me anëtarë të Partisë Demokratike në qytetin e Durrësit, për të diskutuar mundësitë e daljes nga situata. Ndërsa përpos kësaj lëvizje në bazë, përmes një turi në të gjithë vendin, në ditë në vijim do të mblidhen firmat për të thërritur Këshillin Kombëtar të PD, për të anuluar procesin e zgjedhjes së kryetarit të ri në 22 Korrik. "Unë vetë bashkë me një grup kolegët do të bëjmë një tur nëpër Shqipëri, në mënyrë që të takohemi me demokratët dhe t'u kërkojmë që të gjejnë zgjidhje për partinë tonë. Nuk janë me rëndësi emrat, mund të jetë me rotacion. Figura të lartë", paralajmëroi Patozi.



### Takimet

Selami:  
Do të rikthej  
vlerat e së  
djathtës



Në takimet me strukturat e Qarkut të Tiranës, kandidati për kryetar i Partisë Demokratike Eduard Selami, ka theksuar se platforma e tij synon të rikthejë të djathtën në identitet. "Po vazhdojmë të humbasim se kemi braktisur strukturat, kemi braktisur strukturat, kemi braktisur strukturat demokracinë, dhe do të rikthehem mi të fuqishëm vetëm kur të vendosim këto themele, më të forta se i kemi pasur", tha Selami. Selami kërkon një analizë të sinqertë, pasi siç u shpreh ai asgjë nuk zgjidhet duke dalë në dritare dhe gjetur gabimet tek të tjerët. "Është koha për një analizë të sinqertë, dhe ti shikojmë gjerat në sy. Nuk mjafton të shohim ca bën kundërshtari, kundërshtari atë punë ka. I përka atij grupi që kur diçka nuk shkon, gabimin e gjej të vetja. Njerëzit që shikojnë në dritare për të fajësuar të tjerët, nuk janë ata që ecin përpara dhe kanë sukses", tha Selami.

# Rama: Reforma në administratë, jo në dorë të partive

“Denonconi çdo rast abuzimi në zyrat e shtetit, ky nuk është spiunim por qytetari”

**K**ryeministri Edi Rama ka zhvilluar ditën e martë një dëgjese me banorët e Vaqarrit, në periferi të Tiranës, në kuadër të turit 30-ditorë të ndërmarr për bashkëqeverisjen me qytetarët. Rama ka prezantuar platformën qeverisëse “Për Shqipërinë që duam” dhe u ka bërë thirrje të gjithë shqiptarve të jenë pjesë e bashkëqeverisjes në këtë mandat dytë. Rama foli për një koalicion të madh të PS-së me qytetarët, të cilët do jenë pjesë aktive, ndërsa kërkoi që të asistojnë në përmirësimin e qeverisjes së vendit katër vitet e ardhshme. “Të mos lëmë asnjë ditë të këtij mandati të ri pa bërë një hap përpara. Po ndërtojmë bazën e një koalicioni të madh që do të jetë fuqia e domosdoshme për sfidat shumë të mëdha që kemi përpara. Koalicioni i madh mes PS-së dhe njerëzve të zakonshëm, të cilët duam t’i bëjmë pjesë aktive të qeverisjes. Kjo për shkak të të shkuarës, por edhe pse është e re, tingëllon si një mënyrë për të komunikuar dhe për të thënë që ne jemi me njerëzit dhe kaq. Por nuk është kaq, sepse unë besoj shumë se edhe falë teknologjisë së re, përdorimit masiv të internetit, të krijomë bashkëqeverisje reale ku çdo individ që do të jetë pjesë e një trupe të madhe, ministra, deputetë dhe drejtues të PS që do të qeverisë e vetme vendin pa koalicion me parti të tjera dhe vetë njerëzve të jetë trupë që komunikon në kohë reale për problemet, nismat e ndryshme të qeverisë”, tha Rama. Pjesëmarrës në këtë takim me banorët e Vaqarrit ishte dhe Saimir Tahiri, i cili në mbyllje të takimit i bëri thirrje të gjithë pjesëmarrësve të jenë pjesë e platformës qeverisëse



## Vaqar

### Banorët sugjerimet dhe ankesat e tyre Ramës

**B**anorët e Vaqarrit të cilët ishin pjesë e këtij takimi i shprehën kryeministrit Rama sugjerimet dhe ankesat e tyre. Problematikat kryesore që parashtruan banorët lidheshin me: ujin e pijshëm, kanalizimet për vaditjen e tokave, problemet me pronën, legalizimet dhe probleme në infrastrukturën e rrugore. Pyetjeve të banorëve për problematikën me ujin e pijshëm Rama iu përgjigj se shumë shpejtë qeveria do të ndërmarr një plan për të siguruar ujë të pijshëm në të gjithë vendin dhe shtoi se që realizimi i këtij projekti kërkon kohë. Rreth pyetjeve të banorëve për legalizimet kryeministri tha se shumë shpejt do të krijojë vetëm një Agjenci Kombëtare për Pasuritë e Patundshme. Kjo agjenci do të bashkojë ALUIZNI-n dhe Hipotekat në një godinë të vetme duke shmangur kështu burokracitë e kota të cilat i shkaktojnë shumë humbje kohe qytetarëve shqiptarë.



“Për Shqipërinë që duam”. Ky ishte takimi i parë me banorët në këtë zonë dhe zgjati rreth 60 minuta.

### RISTRUKTURIMI NË ADMINISTRATË

Për të patur një bashkëqeverisje të suksesshme me njerëzit e zakonshëm, Edi Rama iu rikthye edhe një herë premtimeve gjatë fushatës kur kërkoi timonin vetëm për PS, duke premtuar një ristrukturim të të gjithë administratës, duke nisur nga puna e deputetëve apo mënyrës sesi është ndërtuar sot administrata. Kreu i qeverisë theksoi se reforma në administratën publike, e 4 vitet e ardhshme nuk do jetë në dorë të partive politike, por në shërbim të qytetarëve. “Si do risistemohet administrata? Që nga mënyra si është strukturuar qeveria, që duhet të ndryshojë; tek mënyra se si është ristrukturuar puna e deputetëve, që duhet po ashtu të ndryshojë; dhe patjetër tek mënyra si është ristrukturuar çdo mekanizëm e çdo zyrë që duhet të ndryshojë. Jam i bindur që aq sa është e vështitë, aq e thjeshtë bëhet nëse jemi bashkë”, theksoi Rama. Rama ftoi qytetarët që t’i bashkohen kësaj lidhjeje të re mes qeverisë dhe qytetarëve, duke shpjeguar edhe mënyrën sesi ajo do të funksionojë. “Çdo individ që ka dëshirën dhe vullnetin të bëhet pjesë e një trupe të madhe bashkëqeverisjeje mes

### Ngrini zërin

“Është krijuar një ide se nëse ankohesh për zyrtarin shtetëror, ai do të hakmerret. Ka dhe një ide tjetër se thonë: Po pse more ç’do bëj unë do spiunoj? Ka një bazë nga e shkuara por nuk janë sjellje normale në një shoqëri evropiane”.

### Koalicioni me qytetarët

“Falë teknologjisë së re, përdorimit masiv të internetit, të krijomë bashkëqeverisje reale ku çdo individ që do të jetë pjesë e një trupe të madhe, ministra, deputetë, drejtues të PS dhe vetë njerëzve të jetë trupë që komunikon në kohë reale”.

deputetëve dhe drejtuesve të PS, që do qeverisë e vetme vendin pa koalicion me partitë e tjera, mund të jetë një trupë që komunikon në kohë reale”, tha Rama.

### DENONCONI ABUZIMET

Kryeministri Edi Rama i ftoi të gjithë shqiptarët të denoncojnë rastet e abuzimit të punonjësve të administratës shtetërore. Rama shpjegoi se ky nuk është spiunim, por qytetari të ngrish zërin kundër padrejtësive, ndërsa kujtoi se një gjë e tillë ndodh dhe me qytetarët gjermanë dhe francezë, kur hasin në papërgjegjshmërinë apo korrupsionin e zyrtarëve shtetërorë.

Kryeministri i ftoi qytetarët të denoncojnë çdo rast abuzimi në zyrat e shtetit, njësoj siç ndodh në Evropë. “Është krijuar një ide se nëse ankohesh për zyrtarin shtetëror, ai do të hakmerret. Ka dhe një ide tjetër se thonë: Po pse more ç’do bëj unë do spiunoj? Ka një bazë nga e shkuara por nuk janë sjellje normale në një shoqëri evropiane. Shkaqet nuk vijnë nga qytetarët por nga mënyra si është sjellë autoriteti shtetëror përkundërt qytetarit. Nuk janë spiunë gjermanët, francezët, janë qytetarë të mirë që kur shohin se dikush prish rregullat e bëjnë me dije autoritetet shtetërore”, u shpreh Rama.

## NE REPORT TV

### Silva Caka: S’do bllokojmë bashkitë e PS, por as ata të LSI

**D**eputetja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Silva Caka, e ftuar në studion e emisionit “45 Minuta” në Report TV, ka deklaruar se LSI nuk do të bllokojë punën e bashkive të Partisë Socialiste. Caka është shprehur se nuk ka asnjë kuptim që të dëmtohet jeta e qytetarëve, si dhe ka shtuar se as Partia Socialiste nuk duhet të bllokojë

bashkitë të cilat drejtohen nga Lëvizja Socialiste për Integrim. Ajo gjithashtu ka folur edhe për betimin e Ilir Metës, ish-kreut të LSI, si president më 24 korrik, për të cilin ka thënë se seanca që do të mbahet në parlament është një formalitet. “Është një seancë që është një formalitet i cili parashkohet nga Kushtetuta e Shqipërisë. Nuk do të ketë as-

gjë të veçantë”, u shpreh Caka, e cila e pyetur për një bojkotim të seancës nga disa deputet ka shtuar se Meta u zgjodh me një numër të caktuar votash si president dhe nuk sheh asnjë arsye për bojkotim të seancës. Ndërkohë e pyetur se a ka një plan LSI-ja të formë në të cilën do të bëjë opozitë, deputetja në detyrë, është përgjigjur se

do të ndiqen të gjitha rregullat ligjore që përmban legjislacioni shqiptar për t’i bërë opozitë çdo institucioni ose personi. Në studion e “45 Minutave” në Report TV, Caka ka komentuar edhe një drejtim të mundshëm të Kuvendit të ri nga Gramoz Ruçi, për të cilin ka thënë se shpreson që ta drejtojë me aq tolerancë sa edhe Ilir Meta.



**ESIONA KONOMI**  
TIRANE

**N**iko Peleshi, kryetari i grupit të punës së mandatuar nga Edi Rama për hartimin e një raporti për rristurimin e administratës dhe qeverisë, ka nisur takimet me ekspertë të fushave të ndryshme për të marrë sugjerimet e para. Report TV e gjeti dje në një takim me grupe interesi në fushën e bujqësisë dhe sigurisë ushqimore, nga ku i mori një intervistë mbi projektin e ri të qeverisë dhe administratës. Peleshi tha se do të kemi një arkitekturë krejtësisht të re sa u takon agjencive dhe drejtorive të varësisë, por shtoi se nuk është ende e qartë nëse do të kemi më pak apo më shumë agjenci. Deputeti tashmë i zgjedhur socialist, tha se synohet riorganizim i kompetencave të institucioneve dhe agjencive, madje dhe një rindarje mes funksioneve vendore dhe atyre qendrore.

**Z. Peleshi, ju si drejtues politikë të qarqeve, por edhe kryeministri, keni nisur një tur dëgjësash me qytetarët, që ndër gjërat kryesore, synon mbledhjen e denoncimeve dhe ankesave ndaj zyrtarëve. Ndërkohë, është e mundshme, që qytetarët për qëllime të caktuara të abuzojnë në informacionet që mund të japin. Si do të arrini ju që të verifikoni këto denoncime për të marrë pastaj vendime?**

Kjo është një fushatë dëgjësash ku është përfshirë jo vetëm kryeministri, ministrat apo deputetët, por edhe kandidatët për deputetë. Gjitha lista jonë e kandidatëve është përfshirë në këtë dëgjësë publike, që në thelb është materializimi i asaj çfarë kemi thënë gjatë fushatës, por jo për shkak të fushatës, pra, bashkëqeverisje me qytetarët. Ne, për ta thënë hapur, kemi shpëtuar nga nevoja për të patur koalicionet partish, gjë të cilën kryeministri e thotë edhe në mënyrë më metaforike, përmes tepsisë, por kjo na e ka bërë akoma më të domosdoshme, ndërtimin e një koalicioni të ri, që është koalicioni me qytetarët. Këtë koalicion ne duam që realisht ta kthejmë në një kulturë të re qeverisëse. Duam të ndërtojmë një kulturë të tryezave të përbashkëta ku komuniteti të ulët me deputetët, me përfaqësuesit e vetë, më vonë edhe me qeverinë e re, dhe të ndajë shqetësimet dhe problemet. Kur ne kemi shkuar në zyrë në vitin 2013, nuk është se kemi gjetur në tavolinat tona të punës dosje projektesh, projekt-idesh apo prioritesh të çdo zone të Shqipërisë. Tani do ta kemi këtë produkt, pasi, siç e thashë, në çdo njësi administrative të Shqipërisë, çdo deputet sipas zonës së tij të mbulimit, është duke zhvilluar këto biseda, ku dalin këto problematike, dhe pastaj filtrohen 3-4 prioritete të apo çështjet kryesore. Ne nuk jemi një vend i pasur, madje as vendet e pasura nuk kanë mundësi që të realizojnë me burimet e veta financiare përm-bushjen e të gjitha problemeve. Kjo bën të domosdoshëm prioritarizimin. Por, prioritarizim pa njohur problematikat, nuk mund të ketë. Ky është qëllimi i këtij turi të madh që do të vijojë përgjatë gjithë verës, deri në shtator kur qeveria e re do të marrë mandatin për të qeverisur.

**Korça nuk është e vetmja, por ka filluar që aty shkarkimi nga detyrat shtetërore e njerëzve që janë të LSI-së. Po bëni vetëm një spastrim për shkak të tesserës së partisë, apo keni dhe do të keni në konsideratë**



# Peleshi: Ja si do të rristrukturohet qeveria dhe administrata

## Flet kryetari i grupit të punës për reformimin: Duam të ndërtojmë një arkitekturë të re



### Numri

Ne nuk kemi aktualisht një parim numerik për të ndjekur, pra, nëse do të ketë më shumë agjenci apo më pak agjenci, apo më shumë ministri, a më pak të tilla. Ajo që na orienton është vetëm efica apo efikasiteti i agjencive tona.

### edhe performancën institucionale të funksionarëve?

Kur ne flasim për administratë meritokratike, nuk e kemi fjalën për nëpunës të cilët mbajnë në xhep tesserën e një partie të caktuar, por e kemi fjalën për të ndërtuar një profil të nëpunësit, i cili shkon aty jo për shkak të tesserës, qoftë kjo edhe tessa e Partisë Socialiste që është sot e vetme në pushtet. Ne duam

### Arkitektura

Duam të ndërtojmë një arkitekturë të re të të gjitha agjencive dhe institucioneve të varësisë, në nivel lokal dhe qendror, për të pasur një strukturë qeverisëse më efica, më efikase. Ne nuk vuajmë vetëm nga cilësia e punës, por edhe nga zgjidhje jo inteligjente të arkitekturës.

**grupi pune, i cili do të paraqesë një raport rekomandimesh se si duhen reformuar ato. Si po e ndërtoni këtë punë, dhe, a keni një projekt se si do të shkohet? Në shkurtim a shtim të portofolave ministrorë?**

Unë dhe 4 kolegë, ministra e ish ministra të qeverisë sonë, jemi në një grup pune për këtë çështje. Ne kemi ndërtuar edhe një grup ekspertësh të çështjeve të ndryshme për të mbuluar të gjithë sektorët. Duam të ndërtojmë një arkitekturë të re të të gjitha agjencive dhe institucioneve të varësisë, në nivel lokal dhe qendror, për të pasur një strukturë qeverisëse më efica, më efikase. Ne nuk vuajmë vetëm nga cilësia e punës, por edhe nga zgjidhje jo inteligjente të arkitekturës. Kemi shpesh herë agjenci të mbivendosura me njëra-tjetrën, apo agjenci të ngarkuara shumë me punë, ndërsa agjenci të tjera vegjetojnë. Mbivendosja e funksioneve shpesh herë do të thotë edhe ngarkesë për qytetarët, ulje rendimenti. Ato institucione apo inspektorate që kanë lidhje me biznesin kthehen pastaj në shtim burokracie apo dhimbje koke për biznesin. Unë vij tani nga disa takime

**Kryeministri ka folur për një rristrukturim jo vetëm të administratës, por edhe të ministrive. Ju jeni mandatuar prej tij në krye të një**

### GRUPI I PUNËS

Niko Peleshi Kryetar

Damian Gjickuri

Bledi Çuçi

Lindita Nikolla

Ogerta Manastirliu

në funksion të kësaj detyre, me grupe interesi në fushën e bujqësisë dhe sigurisë ushqimore. Kam takuar në mënyrë të ndarë përfaqësues të industrisë së qumështit, mishit, thertoreve, etj. Tani do të vazhdoj me perimet, sepse në këtë punë të marrim edhe mendimin e grupit të interesit. Ata e dinë më mirë se ku ka moseficientë nga administrata. Kjo moseficientë na vjen edhe nga puna e dobët e punonjësve, të cilët, duhet ta pranojmë, shpesh herë janë aty jo për shkak të meritës, por për shkak të partisë, por edhe për shkak se nuk janë të ndërtuara mirë strukturat. Ka funksione të ndara mes pushtetit qendror dhe vendor që nuk meritojnë të jenë të tilla, sepse kur një funksion është i ndarë krijon kakofoni, përplasje, apo paqartësi. Duam në këtë mënyrë të shmagim burokracitë, duke reduktuar korrupsionin.

**Kjo është sa u takon agjencive. Unë dua t'ju pyes për numrin e ministrive. A keni një orientim nëse duhen shkurtuar apo shtuar portofolet ministrorë?**

Këtë nuk mund ta them unë. Natyrisht që është e drejta e kryeministrit për të propozuar një strukturë të qeverisë. Ne nuk kemi aktualisht një parim numerik për të ndjekur, pra, nëse do të ketë më shumë agjenci apo më pak agjenci, apo më shumë ministri, a më pak të tilla. Ajo që na orienton është vetëm efica apo efikasiteti i agjencive tona. Nëse do të ketë nevoja për zgjerim do t'i zgjerohet. Në rast se do të ketë agjenci ku punonjësit vegjetojnë, padyshim do të ketë shkurtime. Nuk kemi një orientim sasior nga kryeministri. Ai do të jetë cilësor.

**Z. Peleshi, është normale që ju të keni ambicie për të qenë pjesë e qeverisë "Rama II". A keni ju një pritshmëri konkrete, se cilin dikaster do të donit të drejtonit?**

Personalisht unë kam ambicie dhe interes të kontribuoj për komunitetin dhe për ata që më kanë besuar. Unë nuk kam pasur më parë një mandat deputeti. Kam pasur dy herë mandatin e kryetarit të bashkisë dhe pastaj kam pasur një mandat të zgjedhur, por të përzgjedhur nga kryeministri, të cilën jam munduar ta bëj me shumë përkushtim. Ky mandat që kam marrë sot, nga njëra anë më bën krenar, nga ana tjetër më bën edhe shumë përgjegjës. Sidomos, sepse përfaqësoj një zonë që ka prodhuar histori, ka qytetari dhe kërkesa të larta. Kërkesat janë rritur edhe për shkak të standardit të arritjeve në atë zonë. Standardi i kërkesave është rritur në atë zonë. Prandaj, të ta them me pak fjalë, nuk ka rëndësi se çfarë pozicioni do të ketë Niko Peleshi. Unë, në këtë mandat që tashmë e kam marrë me votën e qytetarëve, besoj kam të gjitha mundësitë të vijoj të kontribuoj e të ndryshoj për mirë jetën e njerëzve. I vetmi frymëzim dhe kënaqësi e imja, është kur e shikoj që përmes punës sime të përditshme, kam bërë më të mirë jetën e komunitetit.



## Negociatat

KE ka rekomanduar hapjen e negociatave duke u bazuar në progresin e besueshëm dhe të ndjeshëm të implementimit të reformës në drejtësi, veçanërisht në verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

# Hahn: Qeveria e re të përqendrohet te Vetingu

“Vetingut është vendimtar në drejtimin e luftës kundër krimit dhe korrupsionit”



Johannes Hahn

**K**omisioneri për Fqinjësinë Evropiane dhe Negociatat e Zgjerimit, Johannes Hahn vlerëson faktin që zgjedhjet parlamentare të 25 Qershorit u zhvilluan pa u bojkotuar nga partitë politike. Johannes Hahn tha se tani Bashkimi

Evropian pret që qeveria e re duhet të përqendrohet veçanërisht në zbatimin e reformës në drejtësi dhe procesit të Vetingut. Sipas tij, zbatimi i Vetingut është vendimtar për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. “Unë përshëndes faktin që zgjedhjet u zhvilluan pa u bojkotuar

nga partitë politike. Tani ne presim një qeveri të vendosur për ta çuar vendin përpara në rrugën e integritetit drejt BE-së, nëpërmjet reformave të vazhdueshme. Qeveria e re duhet përqendrohet veçanërisht në zbatimin e reformës në drejtësi dhe procesit të Vetingut, i cili është vendimtar në drejtimin

e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit”, tha Hahn.

### INTEGRIMI

Në një intervistë për gazetën tema, Hahn tha se me ngritjen e organeve të verifikimit e gjyqtarëve dhe prokurorëve Shqipëria ka arritur progres

të besueshëm. Por Komisioneri për Fqinjësinë Evropiane dhe Negociatat e Zgjerimit shtoi se vendimi për çeljen e negociatave varet nga zbatimi i Vetingut. “Komisioni Evropian ka rekomanduar hapjen e negociatave duke u bazuar në progresin e besueshëm dhe të ndjeshëm të implementi-

mit të reformës në drejtësi, veçanërisht në verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Mund të themi se me ngritjen e organeve të verifikimit është arritur shumë progres. Presim që në vjeshtë këto organe të fillojnë punën. Rekomandimi ynë do të varet nga rezultatet e arritura”, tha ai.

## Zgjedhjet

BRUKSEL

# Negociatat, OSBE dhe PE përplasen për Shqipërinë

Debatet, Eduard Kukan: Duhet të hapen negociatat

**Z**hvillimi i zgjedhjeve të 25 qershorit në Shqipëri ka shkaktuar një mosmarrëveshje midis OSBE/ODHIR dhe delegacionit të Parlamentit Evropian. Për Parlamentin Evropian, procesi duhet parë më shumë në kontekstin politik, sesa në atë teknik siç e ka peshuar OSBE/ODHIR. Kjo mosmarrëveshje është shprehur hapur prej kreut të delegacionit të Parlamentit Evropian, Eduard Kukan në komisionin e punëve të jashtme të Parlamentit Evropian. “Unë i kam bërë të ditura tashmë sfidat për të cilat u përballëm me OSBE-ODHIR për zgjedhjet në Shqipëri. Thënë shkurt, ne konsiderojmë, se OSBE-ODHIR nuk e ve theksin mjaftueshëm

në kontekstin politik të zhvillimit të zgjedhjeve”, tha eurodeputeti Eduard Kukan. Klaus Buchner, eurodeputet tha se zgjedhjet u zhvilluan normalisht. “OSBE vëzhgoi se nga pikëpamja teknike rrezikohet kufiri i përcaktuar prej 3% dhe se vazhdueshit kishin konstatuar parregullsi në disa zona votimi dhe për këtë i gjithë procesi mund të binte poshtë. Ndërkohë, ne pamë që zgjedhjet u zhvilluan normalisht”, tha ai. Për eurodeputetët, moskontestimi i zgjedhjeve dhe mungesa e ngërçeve të mëtejshme politike në Shqipëri tregon për një rikthim të normalitetit demokratik në vend. Ndaj, siç

e kanë cilësuar disa parlamentarë evropianë, nuk ka më kuptim më të shtyhet hapja e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. “Të gjitha forcat politike u gabuan në parashikime. Rama që dyshonte se nuk do kishte shumicën e duhur për të qeverisur, e arriti këtë shumicë. Basha mendonte se Partia Demokratike ishte krah për krah me atë socialiste, ndërkohë që rezultati tregoi që kishte një diferencë të rëndësishme midis tyre dhe cunami i anonçuar nga Meta nuk ndodhi. Fakti që nuk pati kontestim apo bllokim tregon që ka një rikthim të normal-

itetit demokratik në Shqipëri. Tani duhen vijuar reformat, por shpresojmë në hapjen e negociatave të anëtarësimit, pasi tashmë nuk ka kuptim që kjo të shtyhet sërisht”, pohoi eurodeputeti Christian Dan Preda. Sipas Abnews, Eduard Kukan e vuri theksin tek rekomandimet për të zgjedhjet e ardhshme. “Duhet theksuar, se rekomandimet e OSBE/ODHIR për procesin zgjedhor e kryesisht për depolitizimin e administratës zgjedhore nuk janë zbatuar. Këto rekomandime duhen zbatuar në kohën e duhur para zgjedhjeve të ardhshme. Tashmë është detyrë e të gjitha partive politike që të marrin pjesë në mënyrë konstruktive në Parlamentin e ri. Qeveria e re duhet të ecë përpara me reformat e integritetit veçanërisht me zbatimin e reformës së gjyqësorit dhe procesit të Vetingut”, tha ai. Gjatë diskutimit, eurodeputetët janë shprehur, se Bashkimi Evropian duhet të angazhohet më shumë në procesin e integritetit me vendet e Ballkanit oër të zhbërë perceptimin e krijuar në vendet e Ballkanit, që procesi i anëtarësimit është ngrirë dhe perspektiva e anëtarësimit mund të marrë me vite të tëra.



NË FOTO: Eduard Kukan

### BASHKIMI KOMBËTAR, HAHN: RREZIK

I pyetur lidhur me paralajmërimin për “bashkim kombëtar” në rast se BE mbyll dyert për Shqipërinë dhe Kosovën, Hahn gjykon se ky diskutim është i rrezikshëm dhe i papranueshëm. “Deklarata të cilat mund të interpretohen si ndërhyrje politike në vendet fqinje, nuk ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe e ekspozojnë rajonin ndaj rreziqeve të retorikës përshkallëzuese dhe tensioneve etnike”, tha ai. Hahn gjithashtu inkurajon deputetët që të punojnë së bashku për perspektivën e Shqipërisë në BE përtej vijave partiake.

### SAMITI I TRIESTES

Hahn ka folur edhe lidhur me samitin e Triestes dhe pritshmëritë që duhet të kenë vendet e Ballkanit Perëndimor ndaj të ashtuquajturit procesi i Berlinit. “Një nga rezultatet kyçe do të jetë shpallja e “paketës vjetore të ndërlidhjes” të projekteve të transportit dhe infrastrukturës energjetike. Ne gjithashtu shpresojmë që udhëheqësit do të nënshkruajnë Traktatin e Komunitetit të Transportit dhe do të miratojnë një plan veprimi për të krijuar një Zonë Ekonomike Rajonale. Që nga fillimi i tij tre vjet më parë, procesi i Berlinit ka sjellë një dinamikë të re në zhvillimin dhe bashkëpunimin rajonal të Ballkanit Perëndimor me rezultate konkrete. Prandaj, i mirëpres idetë e reja konstruktive, siç janë ato të nisura kohët e fundit nga Ministri i Jashtëm gjerman, se si ta bëjnë procesin edhe më dinamik dhe si të fitojnë edhe më shumë fonde për t’u përgjigjur nevojave të investimit që ka rajoni”, ka pohuar Hahn.

## OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë agjent marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

**PERSONAT E INTERESUAR TË DËRGOJNË CV E TYRE NË ADRESËN:**  
marketing@shqiptarja.com

TË KETË ARSIM TË LARTË  
TË KETË PËRVOJË PUNE  
TË JETË I GATSHËM PËR TË PUNUAR NË TERREN

# By-Pass-et Fier e Vlorë presin OK e bankave nga BE

Pas prishjes së kontratës me Serenissima-n, të zhvillohet tender vetëm për pjesën e mbetur

**B**urim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar pohojnë se janë në pritje të procedurave për hapjen e tenderit për përfundimin e punimeve në dy nyje të rëndësishme rrugore nacionale: By-Pass-it Fier dhe atij të Vlorës. Fituesi i të dy tenderave ishte kompania italiane Serenissima, e cila pati probleme me ndryshimin e pronësisë në vendin e saj, duke ndërprerë edhe punimet në Shqipëri.

Në një intervistë dhënë në prill 2017 për Shqiptarja.com, drejtori i përgjithshëm i ARRSH Dashamir Xhika deklaroi se, ndërkohë që punimet në Vlorë janë ende në fazë fillestare, ato të Fierit janë ndërprerë kur pjesa më e madhe është kryer. "Mjaftojnë 2-3 muaj që të përfundojë By-Pass-i i Fierit", tha ai.

Por, duke qenë investime të rëndësishme në infrastrukturë, që financohen nga by banka kryesore evropiane, natyrshëm qeveria shqiptare është e detyruar të marrë mendimin edhe të Bankës Evropiane për Rindërtim e Zh-



villim dhe Bankës Evropiane të Investimeve. Për më tepër, që ARRSH, si autoritet kontraktor shqiptar, kërkon edhe të përshejtojë procedurat e garës, duke e reduktuar atë


në një fazë të vetme, ndërkohë që rregullisht duhet të kryhen dy faza.

#### KOMPANIA

Në kohën kur Serenissima

aplikoi dhe fitoi tenderat për ndërtimin e By Pass-ëve të Fierit e të Vlorës, ajo ka qenë një kompani me një CV të pasur në vendin e saj, degë e "A4 Holding", që menaxhon një nga autostradat më të rrëhura në Itali, si dhe pronare e shoqërisë "Brescia-Padova". Por, nga ana tjetër, edhe vetë qeveria shqiptare u habit me çmimin anomalisht të ulët të propozuar nga ajo për të kryer punimet. Për ndërtimin e By Pass-it të Fierit, kontrata u nënshkrua me Autoritetin kompetent Rrugor më 18 mars 2013, gjatë qeverisë Berisha. Dhe, më pas, me qeverinë Rama, në muajin mars 2015 u nënshkrua marrëveshja edhe për ndërtimin e By Pass-it të Vlorës.

By Pass-i i Fierit, gjatë projektimit, u vlerësua se do të kushtonte rreth 60 milionë



#### → BLOKIMI

Ndërprerja e punimeve nga ana e shoqërisë italiane ka krijuar probleme sociale me qindra punëtorë shqiptarë të papaguar për muaj të tërë. Shteti s'ka përgjegjësi ligjore, por nuk mund të qendrojë indiferent

euro, të gjitha të financuara me kredi. Por në tenderin e zhvilluar, kompania italiane "Serenissima" ofroi kryerjen e punimeve për më pak se 40 milionë euro, 20 milionë më pak se sa fondi limit.

Më pas, jo vetëm që punimet u bllokuan, në Fier e Vlorë, por

dega e kompanisë sipërmarrëse në Shqipëri, Serenissima Costruzioni Tirana, deklaroi bilanc me humbje prej 156 milionë lekësh (më se 1.1 milionë euro) për vitin 2015, pasi pati deklaruar humbje prej 166 milionë lekësh të tjera edhe në vitin 2014.

## PENALITETET

# HEC-et vendore, koncesionarët në gjyq, nuk nisën prodhimin

**Z**varritja e investimeve dhe mosrespektimi i kontratave për nisjen e prodhimit ka sjellë përplasje në gjykatë mes koncesionarëve të hidrocentraleve dhe Ministrisë së Energjetikës. Kjo e fundit ka paditur në Gjykatën Administrative të paktën dy koncesione, të cilat nuk kanë nisur prodhimin e

energjisë që në vitin 2011, siç parashikon kontrata. Ministria i ka kërkuar Gjykatës të detyrojë koncesionarin e përbërë nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "Titan" sh.p.k. dhe "Osmani" sh.p.k., dhe Shoqërisë Koncesionare "HEC-i Bishnica 1,2" sh.p.k., t'i paguajë paditësit penaltetin në masën 5% të vlerës

së prodhimit të përcaktuar për vitin 2011 dhe vitin 2012, referuar Kontratës Koncesionare lidhur mes shtetit dhe këtij konsorciumi privat për shfrytëzimin e burimeve ujore për hidrocentralin e Bishnicës.

Po kështu, në padinë se depozituar në Gjykatën Administrative Ministria kërkon edhe detyrimin e Koncesion-

arit, Shoqëria "BLE-KLO-AR" sh.p.k., si dhe Shoqërisë Koncesionare "HEC-i Tërrolit" sh.p.k., të paguajë paditësit penaltetin në masën 5% të vlerës së prodhimit të përcaktuar për vitin 2011 dhe vitin 2012 në Tërrol. Këto masa mendohet të detyrojnë koncesionarët e tjerë të realizojnë projektet.



## PROJEKTI/ LEJA U MIRATUA ME URGJENCË NGA KUVENDI

# Porti i Karpenit, pas një viti regjistrohet kompania



**V**etëm një vit pasi ka marrë miratimin nga Kuvendi për përgatitjen me precedencë të një projekti për Portin e Karpenit në Kavaja, me parashikim investimi prej 5 miliardë dollarësh, kompania nismëtare Star Bridge Port Developments Limited, që kishte shprehur edhe interes për atë që u quajt projekti "Morgan", ka vendosur të zyrtarizojë prezencën e saj në Shqipëri. Referuar ekstraktit në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton që STAR BRIDGE PORT DEVELOPMENTS (ALBANIA) të jetë regjistruar në prill 2017, si subjekt shqiptar me adminis-

#### → ORTAKËT

STAR BRIDGE PORT DEVELOPMENTS (ALBANIA) u regjistrua në prill 2017 si subjekt shqiptar. Ortakë të tij janë me 5% Arjan Stajka, me 35% GL2 Albania dhe 60% Star Bridge Port Developments Limited. Kapitali: 1.000 lekë

trator Michael George Poeder-Kent. Ortakë të saj janë me 5% Arjan Stajka, me 35% GL2 Albania, dhe 60% Star Bridge Port Developments Limited. Kapitali i kompanisë, sipas dokumenteve të dorëzuara në QKB, është qesharak: 1.000 lekë.

Vitin e kaluar, kur Star Bridge Development Limited

dorëzoi projektin për zhvillimin e Portit të Karpenit, sipas Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ai "ishte një subjekt për qëllime të veçanta, i regjistruar në Angli dhe Uells dhe i përbërë nga kompani prestigjioze në fushën e projektimit dhe ndërtimit të porteve, arkitekturës dhe

konsulencës për projektet e porteve". Në atë kohë kompania nuk ishte regjistruar ende në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Sa u përket ortakëve të tjerë, GL 2 Albania është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në vitin 2010 dhe operon kryesisht në fushën e konsulencës, projektimit dhe ndërtimit. Nga ana tjetër ortakë, Arjan Stajka rezultoi si aksioner i vetëm në kompaninë Viki sh.p.k., që sipas ekstraktit të QKR është regjistruar qysh nga viti 2003. Edhe kjo kompani operon në kryesisht në fushën e ndërtimit.

## DETYRIMI

Pranë çdo subjekti privat i cili ka më shumë se 100 të punësuar, do të caktohet një njësi përgjegjëse e cila regjistron, heton administrativisht, shqyrton sinjalizimet për rastet e korrupsionit

**K**ryeinspektori i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave Shkëlqim Ganaj u ka dërguar këto ditë një letër bizneseve me mbi 100 të punësuar, duke u kërkuar që, deri më 15 korrik, të dorëzojnë gjeneralitetet e personave të përzgjedhur si "sinjalizues". Kjo është në kërkesë në zbatim të ligjit "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", miratuar një vit më parë. Në shkresë thuhet se, në rast se nuk zbatohet kjo kërkesë, subjekti ngarkohet me përgjegjësi administrative dhe penale.

Ligji "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" do të funksionojë në administratën publike por edhe tek kompanitë që kanë mbi 100 të punësuar. Rastet që do të sinjalizohen do të lidhen me korrupsionin, shpërdorimin e detyrës, ushtrimin të ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave ose marrjen e vendimeve apo shpërdorimin e të ardhurave të buxhetit. Sinjalizuesit do të jenë punonjës të institucionit publik por edhe atij privat. Edhe këta të fundit gëzojnë status dhe mbrojtje të



## LIGJI

Nga data 1 korrik 2017 kanë hyrë në fuqi efektet juridike të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.60/2016, datë 2.6.2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", edhe për subjektet private

shpërdorimit të detyrës ose kompetencave, ushtrimin të ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave ose marrjen e vendimeve, shpërdorimit të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, përfitimt të paligjshëm të interesave si dhe çdo akt tjetër të ngjashëm me to të kryer në subjektin tuaj nga pronarët, administratorët, drejtuesit dhe cilido tjetër, hetimin e këtyre rasteve nga ILDKPKI dhe përcjelljen e tyre organit të Prokurorisë dhe Policisë kur gjenden elementë të veprave penale të mësipërme.

Pranë çdo subjekti privat i cili ka më shumë se 100 të punësuar, caktohet një njësi përgjegjëse e cila regjistron, heton, administrativisht, shqyrton sinjalizimet për rastet e korrupsionit pranë ILDKPK sipas ligjit. Për sa më sipër, mbartni detyrimin për ngritjen e njësisë përgjegjëse dhe njoftimin me shkrim të Inspektorit të Përgjithshëm për krijimin e saj së bashku me gjeneralitetet, pozicionet e punës, si dhe kontaktet e punonjësve të caktuar brenda datës 15.07.2017. Shkelja e detyrimeve të përcaktuara në ligj ju ngarkon me përgjegjësi administrative dhe penale".

## ILDKP: Biznesi i madh të caktojë "sinjalizues"

Ligji "Për sinjalizimin" do të funksionojë në administratë, por dhe tek kompanitë me mbi 100 të punësuar

veçantë me ligj.

### SA MË POSHTË, VJON LETRA E KRYEINSPEKTORIT GANI.

"Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit

të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave ju bën me dije se më datë 1.07.2017 fillojnë të zbatohen efektet juridike të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 60/2016, datë 2.6.2016 "Për sinjalizimin

dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", për subjektet private. Qëllimi i këtij ligji është marrja e informacioneve dhe sinjalizimeve nga sinjalizuesit, njësisë përgjegjëse ose e drejtpërdrejtë nga ILDKPKI

për rastet e veprave penale të korrupsionit, çdo veprimi ose mosveprimi të kundërligjshëm sipas legjisllacionit penal në fuqi, në lidhje me çdo formë të korrupsionit aktiv, korrupsionit pasiv,

## RAPORTI/ BSH: NË RËNIE SHËRBIMI DHE TREGTIA

# Ndjesia ekonomike u ul 9.7% para zgjedhjeve parlamentare

**S**i pasojë e dukshme e paqartësisë politike në prag të zgjedhjeve, treguesi i ndjesisë ekonomike në tremujorin e dytë të vitit 2017 ka shënuar rënie me 9.7 pikë krahasuar me tremujorin e mëparshëm, raporton Banka e Shqipërisë. Niveli më i ulët i treguesit pasqyroi rënie të treguesve të besimit në shërbime dhe në tregti, ndërkohë që besimi i bizneseve të ndërtimit, të industrisë, si dhe besimi i konsumatorëve rezultoi i përmirësuar. Me gjithë këtë zhvillim, niveli aktual i TNE-së në tremujorin në analizë vazhdon të mbetet mbi mesataren afatgjatë të tij dhe më lart nivelit të shënuar në të njëjtin periudhë një vit më parë. Treguesi i besimit në sektorin e industrisë vijoi të rritet me 4.5 pikë përqindje për të dytin tremujor radhazi. Rritja e TBI-së pasqyroi kryesisht dinamikën pozitive të balancës së kontratave porositëse (+10.1 pikë përqindje), ndërkohë që edhe gjendja financiare e bizneseve të se-

ktorit rezultoi e përmirësuar. Treguesi i besimit në sektorin e ndërtimit vazhdoi tendencën rritëse edhe në tremujorin e dytë (+1.7 pikë përqindje), duke e zhvendosur atë lehtësisht mbi mesataren historike të tij. Të dyja balancat përbërëse të TBN-së, kontratat porositëse dhe aktiviteti ndërtues, rezultuan më

të larta kundrejt tremujorit të mëparshëm.

Ndërsa, pas rritjes për tre tremujorë radhazi, treguesi i besimit në sektorin e shërbimeve rezultoi me rënie 18% në tremujorin e dytë të këtij viti, por duke mbetur mbi vlerën e shënuar një vit më parë (+17.1 pikë përqindje) dhe mbi mesataren historike

(+9.5 pikë përqindje).

Edhe treguesi i besimit në sektorin e tregtisë ra me 3.9 pikë përqindje, por mbetet mbi mesataren historike.

Nga ana e tij, treguesi i besimit konsumator u rrit me 1.2 pikë përqindje në tremujorin e dytë. TBK-ja qëndron rreth 3.3 pikë përqindje mbi mesataren e tij historike.



### AUTOMJETET

## Në Shqipëri regjistrohen 563.106 mjete rrugore

Edhe në vitin 2016, Shqipëria pati numrin më të ulët të automjeteve për 1.000 banorë në Europë, duke lënë pas vetëm Turqinë. Sipas të dhënave nga Ministria e Transportit, në fund të vitit 2016, numri i automjeteve për 1.000 banorë në Shqipëri ishte 138.4. Para nesh janë të gjitha vendet e rajonit. Maqedonia ka mbi 190 automjete për 1.000 banorë. Sipas Eurostat (që i referohet vitit 2015) mesatarja e BE-së është 497 makina për 1.000

banorë. Në Shqipëri, në vitin 2016 ishin të regjistruara 563.106 mjete rrugore, por një pjesë e madhe e tyre janë jashtë funksionit, teksa procedurën e kontrollit teknik dhe pagesën e taksave të përcaktuara me ligj, e kanë kryer gjithsej 401.499 mjete rrugore. Mbi 95% e veturave në treg blihen të përdorura. Sipas INSTAT-it, në Shqipëri importohen mesatarisht 30-40 mijë makina në vit, ku rekordin e ka shënuar 2013-a, me rreth 44 mijë të tilla.

### AVIACIONI CIVIL

## Linja ajrore shqiptare nis fluturimet këtë vit



Linja ajrore shqiptare do të nisë fluturimet brenda këtij viti. Pas njoftimit për krijimin e saj nga kryeministri Edi Rama në Turqi, lajmi është konfirmuar nga "Turkish Airlines". Kompania është duke asistuar qeverinë shqiptare në themelimin e kompanisë vendase. Burime nga Kryeministria bëjnë të ditur se kompania do të jetë private. Sipas tyre, fillimisht ajo do të funksionojë me operacione në shkallë të vogël, por me kalimin e kohës numri i fluturimeve dhe destinacioneve do të zgjerohen. Që pas falimentimit të "Belle Air" në vitin 2013, Shqipëria nuk ka asnjë kompani ajrore vendase. Tregu i fluturimeve ajrore në Shqipëri numëron rreth 2.2 milionë pasagjerë në vit dhe gati gjysma e tij dominohet nga kompanitë italiane.

**N**ë zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor, i cili e parashikon Tiranën si një qytet me disa qendra policentrike, një ekip i arkitektëve të Universitetit të Harvard-it, të cilët po bashkëpunojnë me studentë vendas, prezantuan dje 3 projekte konkrete që do të marrin jetë në kryeqytet. Parku Qendror i Bulevardit të Ri, rikonceptimi i Kombinatit si poliçendra e parë e Tiranës dhe Fasadat e qytetit, janë tre projektet të cilat u diskutuan sot në një konsultim publik me ekspertë dhe grupe interesi. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, tha se qyteti ka humbur shumë kohë duke folur për plane urbanistike, të cilat nuk janë realizuar asnjëherë. Ai deklaroi se motoja e Bashkisë së Tiranës në këto dy vite ka qenë realizimi me cilësi dhe në kohë i projekteve për përmirësimin e jetës së qytetarëve. “Kemi dëgjuar shumë plane urbanistike, ide të mëdha, vizione gjigante të udhëheqësve, por që ndonjëherë nuk realizohen. Kemi dëgjuar pa fund për tramin, për plane urbanistike që asnjëherë nuk përkthehen në realitet. Unë besoj se kemi humbur aq kohë duke folur për vizione, sa që modeli që kemi kërkuar të sjellim në Bashkinë e Tiranës është të punojmë 1 vit në kohë rekord për të bërë planin urbanistik dhe menjëherë të fillojmë me zbatimin e projekteve individuale të planit”, u shpreh Veliaj.

#### PROJEKTET

Kreu i Bashkisë deklaroi se pavarësisht debateve që kanë shoqëruar shpesh



#### VELIAJ

“Kemi dëgjuar shumë plane urbanistike, ide të mëdha, vizione gjigante të udhëheqësve, por që ndonjëherë nuk realizohen. Kemi dëgjuar pa fund për tramin, për plane urbanistike që asnjëherë nuk përkthehen në realitet”

#### NË FOTO:

Erion Veliaj në takimin me një ekip të arkitektëve të Universitetit të Harvard-it

## 3 projektet që po hartojnë arkitektët e Harvardit

### Veliaj: Parku Qendror te Bulevardi i Ri, mushkëria e re e qytetit, 6 herë më i madh se Parku Rinia

herë projektet e nisura këto dy vite nga Bashkia, ato në fund kanë rezultuar të suksesshme dhe janë mbështetur nga qytetarët. Më pas, Kryebashkiaku Erion Veliaj prezantoi shkurtimisht edhe tre projektet të cilat janë hartuar me kujdes nga ekipi i arkitektëve të Universitetit të Harvard-it dhe një grup studentësh të arkitekturës

nga Shqipëria. Projekti i parë është projekti për Parkun Qendror te Bulevardi i Ri, një hapësirë e gjelbër, 6 herë më e madhe se Parku Rinia, i cili do të jetë mushkëria e re e kryeqytetit. “Projekti “Ëil-liam”, është projekti i parkut qendror te Bulevardi i Ri që bën fjalë për një hapësirë, e cila është vendosur në të majtë të Bulevardit të Ri,

duke filluar në 500 metrat e parë dhe mbaron deri tek 1.5 km. Është një hapësirë rreth 6 herë më e madhe se Parku Rinia dhe që do të krijojë Parkun e ri Qendror të qytetit. Është një hapësirë që është projektuar që tani si park dhe që tani është negociuar që të gjitha ndërtimet të zhvendosen në periferi dhe ajo hapësirë pranë Bulevardit


të Ri të jetë një mushkëri e re për Tiranën”, tha Veliaj, duke shtuar se pas sheshit “Skënderbej” dhe pas Parkut të Liqenit të Tiranës, atij të Farkës dhe të Kasharit, Parku Qendror do të jetë një nga pjesët më kreative të qytetit. Ashtu, sikurse edhe sheshi “Skënderbej”. “Nuk e di a mjaftojnë librat e kësaj bote për të gjithë debatet dhe të

gjithë sherrin me sheshin. Ja ku jemi sot, kemi çdo javë që bëjmë matjet e ndotjes së ajrit dhe na rezultojnë se i vetmi vend në Tiranë, ku ajri është nën normat e ndotjes së BE, është sheshi “Skënderbej”. Siç e shikoni, edhe sot që është vapë, ka njerëz në shesh, jo më gjatë pasditeve dhe gjatë mbrëmjes që gëlon nga jeta dhe sidomos pjesët e parqeve rreth Muzeut Kombëtar”, shtoi më tej Veliaj. Projekti i dytë është ai që ka të bëjë me idenë e poliçendrave të Tiranës dhe më konkretisht për rikonceptimin e zonës së Kombinatit. Plani i Stefano Boerit parashikon një Tiranë me disa qendra. Projekti i tretë lidhet me transformimin e projektit të fasadave të Tiranës nga një projekt ad-hoc, në një projekt afatgjatë. “Ideja ka të bëjë me transformimin e projektit të fasadave të Tiranës nga një projekt ad-hoc, që është bërë nga një kryetar bashkie që filloi, një që pastaj e ndërpreu fare sepse e kishte inat atë tjetrin që e filloi, dhe një tjetër si administrata jonë që po mundohet ta vazhdojë në mënyrë ad-hoc si te Pazarit i Ri dhe si t'i japë kësaj një lloj uniformiteti. Pavarësisht se kush është kryetar bashkie, projekti i fasadave të Tiranës është një mënyrë për të zbuluar shëmtinë sovjetike që trashëguam nga shumica e ndërtimeve në Tiranë, apo kasinë e ndërtimeve pa leje, apo të një urbanistike të viteve '90 komplet jashtë standardit dhe se si mund ta përkthejmë dhe ta shohim nga një problem, në një mundësi”, u shpreh Veliaj, teksa shtoi se fasadat e Tiranës janë shndërruar në një kartolinë të qytetit.

## TIRANE/ BASHKIA: GJOBA PËR 7 ABONENTË FAMILJARË DHE PËR 3 BIZNESE

# Aksioni I Task-Forcë, ndërpriten 70 lidhje të paligjshme uji

**B**ashkia e Tiranës dhe Ujësjellës-Kanalizime vijuan edhe ditën e hënë punën për disiplinimin e përdorimit të ujit të pijshëm dhe menaxhimin e situatës së emergjencës në kryeqytet, si pasojë e temperaturave të larta dhe thatësirës së zgjatur. Puna e grupeve të punës së Task Forcës, me pjesëmarrjen e Policisë së Shtetit, Policisë Bashkiake, Prefekturës dhe stafit teknik të Ujësjellës-Kanalizimeve të Tiranës, u përqendrua dje në zonat: Farkë, Zall Herr, Petrelë, Babrru, Rr. “Dhimitër Kamarda”, Rr. “Ali Demi”, Rr. “Kont Urani”, Rr. Elbasanit, Rr. “Hoxha Tahsin”, Rr. “M.Shyri”, Liqeni i Thatë, Rr.



#### MASAT

Krahas masave të marra për prerjen e lidhjeve të paligjshme, si dhe të çdo rasti tjetër të abuzimit me ujin e pijshëm që përdoret për qëllime të tjera, kryesisht për ujitje të tokave dhe të mbjellave bujqësore, është punuar edhe për lidhjen e kontratave të rregullta me UKT

e Kosovarëve, zona e “Qytetit Studenti”, zona e ish-Parkut të Autobusëve, si dhe në linjat e transmetimit DN 700 dhe DN 1000. Në fokus ishte shkëputja e çdo lidhje të paligjshme në rrjetin e

ujësjellësit, si dhe të çdo rasti tjetër të abuzimit me ujin e pijshëm.

#### NDËRPRERJET

Nga monitorimi i situatës në terren u verifikuan

709 raste, ku u identifikuan dhe u shkëputën 70 raste të lidhjeve të paligjshme në rrjetin e ujësjellësit, ku uji i pijshëm përdorej për ujitje apo për larje të automjeteve. Në ato raste kur grupet e Task Forcës kanë evidentuar abuzime, subjektet u gjobitën sipas parashikimit në ligj. Vetëm dje u vendosën gjoja për 7 abonentë familjarë dhe për 3 biznese. Krahas masave të marra për prerjen e lidhjeve të paligjshme, si dhe të çdo rasti tjetër të abuzimit me ujin e pijshëm që përdoret për qëllime të tjera, kryesisht për ujitje të tokave dhe të mbjellave bujqësore, është punuar edhe për lidhjen e kontratave të rregullta me UKT, si dhe për



vendosjen e matësve të rinj të ujit. Vetëm dje u nënshkruar 11 kontrata të reja, si dhe 17 aktmarrëveshje për pagesën e ujit. Gjithashtu, specialistët e Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë instaluan edhe 121 matës të rinj uji. Bashkia e Tiranës ka vendosur në dispozicion

të qytetarëve dy numra telefoni pa pagesë, 08004488 të Ujësjellësit të Tiranës dhe atë të Bashkisë 08000888, për të raportuar problemet e furnizimit me ujë të pijshëm, apo të denoncojnë rastet e abuzimit të cilat dëmtojnë rrjetin e ujësjellësit.

# Ish të përndjekurit, 490 përfituesit që kanë marrë lekët

## Financat: Mungojnë certifikata personale ose llogaria bankare nuk është aktive

**M**inistria e Financave ka publikuar listën e ish të përndjekurve politik që u është hedhur kësti i 81 dëmshpërblimit. Financat bëjnë me dije se për një pjesë të ish të dënuarve politik nuk është bërë lëvrimi i kësht, për shkak se mungonë certifikata personale ose numri i llogarisë nuk është aktiv. Radha e dëmshpërblimit sipas ligjit është:

1) Ish të dënuar politikë gra, që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës;

2) Ish të dënuar politikë, që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës dhe që kanë moshën mbi

75 vjeç me hyrjen në fuqi

të këtij ligji;

3) Ish të dënuar politikë, të cilët vuajnë nga sëmundje të rënda, sipas përcaktimit të aktit nënligjor të posaçëm;

4) Ish të dënuar politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës, të cilët

pavarësisht nga moshja, kanë pasardhës të radhës së parë në moshë të mitur, me hyrjen në fuqi të këtij ligji;

5) Ish të dënuar politikë që nuk jetojnë dhe që kanë trashëgimtarë të radhës së parë, të cilët janë në moshë

të mitur me hyrjen në fuqi të këtij ligji;

6) Ish të dënuar politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës dhe që kanë moshën nën

75 vjeç me hyrjen në fuqi të këtij ligji.



### EMRAT E 490 PËRFITUESVE QË KANË MARRË LEKËT

EMËR	ATËSI	MBIEMËR
Bari	Shapo	Grabova
Pjetër	Prend	Marku
Andon	Kristo	Vajo
Mitat	Sihat	Likaj
Ramazan	Sulejman	Taka
Myrteza	Fahri	Bajraktari
Thanas	Dhimitër	Paspali
Ismail	Abedin	Farka
Pjerin	Nush	Daberdaku
Zija	Tafil	Hoxhaj
Tanush	Xhelal	Kaso
Sadik	Ibrahim	Lleshi
Kipe	Gjolek	Abdi
Kolë (Kolec)	Kolë	Bjanku
Dem	Sherif	Mazreku
Tom	Pjeter	Huli
Kristo	Taqo	Loli
Dhimitraq	Nastas	Sguro
Ndue	Kolë	Topulli
Muharrem	Xhemal	Alliu
Aqif	Selman	Leka
Isahak	Toros	Shahnajan
Luigj	Ndoc	Kabashi
Hilmi	Vesel	Freskina
Vasillaq	Dhionis	Orgocka
Mina	Kosta	Kota
Nasho	Mitro	Koraqi
Jani	Agustino	Konomi
Faik	Idriz	Mahmuti
Gjon	Zef	Fizi
Ali	Riza	Arifaj
Sulejman	Ibrahim	Dede
Met	Zenel	Trota
Siri	Vahit	Ahmeti (Ahmetaj)
Zenel	hekuran	Zenelaj
Ibrahim	Zejnel	Agimgostivari
Hristo	Kosta	Mako
Irfan	Hamdi	Morava
Fejzi	Vesel	Çelaj
Skënder	Hajder	Shaholli
Vesel	Banush	Bana
Isa	Isuf	Meaj (Mehaj)
Adnan	Sabri	Nasufi
Piro	Mehdi	Agohitaj
Kapllan	Xhano	Resuli
Ndoc	Marash	Peci

EMËR	ATËSI	MBIEMËR
Ramadan	Fetah	Sadaj
Petro	Milo	Bollano
Dhimitër	Nikolla	Stefo
Reshat	Xhemal	Xhemali
Aladin	Memet	Alemi
Viliam	Neki	Bregasi
Leonidha	Vasil	Zharkalli
Dem	Hysen	Zenelaj
Angjello	Irakli	Bollano
Ismail	Mehmet	Jangulli
Shkëlqim	Rapush	Bumçi
Emin	Sahit	Maksuti
Gani	Yzeir	Palla
Vasil	Kostaq	Sylari
Qazim (Koço)	Dajlan	Mustafa
Myrteza	Abdyl	Blushi
Sadik	Ahmet	Kurtaj
Barjam	Idris	Merkoj
Jovan	Prokop	Xhuvani
Ylli	Salih	Alibali
Xhemal	Madan	Bali
Ibrahim	Tofik	Lami
Rrok	Ndoc	Gjinaj
Pjeter	Prengje	Marku
Ndreko	Spiro	Koco
Nikoll	Zef	Syziu
Thoma	Thanas	Taçi
Baftjar	Hasan	Tabaku
Adnand	Hamit	Myftiu
Abdulla	Ymer	Sollaku
Sali	Zenel	Gasa
Reshat	Qazim	Kripa
Skënder	Feriz	Sallku
Kujtim	Sadik	Zharri
Tom	Nikoll	Brushtulla
Spiro	Dhionis	Vllahu
Qani	Avdulla	Mydin
Cile	Rrok	Gjinaj
Thoma	Kozma	Duni
Mehmet	Muharem	Seitaj
Gjergj	Palokë	Hila
Thoma	Gogo	Grillo
Beqir	Tasim	Topçiu
Pal	Prek	Syku
Eqerem	Veledin	Çapaj
Ahmet	Haxhi	Golemi
Bardhyl	Ahmet	Xhomaqi

EMËR	ATËSI	MBIEMËR
Qemal	Shahin	Dema
Esat	Faik	Gazidedja
Qamil	Baki	Veis
Sotiraq	Nasi	Kristo
Bedri	Hajdar	Tufa
Fitim	Ismail	Xhindi
Robert	Tasim	Bishqemi
Mark	Pjeter	Mikaj
Dul	Hamz	Cufi
Gurazi	Zylfo	Diko
Dhionis	Thodhoraq	Basho
Sezai	Hysen	Turku
Ferit	Nazmi	Çela
Myrteza	Ali	Baboçi
Pëllumb	Halo	Ymeraj
Koço	Vito	Duka
Xhumedin	Musa	Goxho
Irfan	Shaban	Qose
Tanush	Syrja	Frashëri
Shuajp	Jonuz	Kraja
Thanas	Simon	Ndoni
Haxhi	Haziz	Meçalla
Ali	Riza	Gjana
Nevruz	Xhevat	Serezi
Ilmi	Arif	Spata
Fatbardh	Hystref	Frashëri
Ibrahim	Ramazan	Kubati
Tomorr	Imer	Merlika
Gjon	Jak	Lala
Selfo	Qerim	Lumani
Ndoc	Simon	Jakaj
Hajredin	Riza	Zeka
Andon	Tasi	Zaka
Mustafa	Nuh	Nuhu
Bardhi	Musa	Cara
Murat	Tahir	Protoduari
Halit	Bektash	Hymeti
Apostol	Mihal	Thano
Dashmir	Musa	Shehu
Selman	Haxhi	Pazoj
Shaqir	Ismail	Bardhi
Nezir	Ramazan	Stermasi
Agim	Adem	Dika
Pashuk	Filip	Toma
Ervedin	Sali	Salku
Zenel	Qamil	Palla
Kudret	Qëndro	Likaj
Dhimitër	Petro	Bili

EMËR	ATËSI	MBIEMËR
Niko	Thanas	Qafko
Pushtet	Riza	Bektashaj
Demir	Abaz	Alia
Luan	Qemal	Burimi
Vesel	Ismail	Jangozi
Hakim	Dule	Isaraj
Nikoll	Gjok	Përlesi
Dalip	Muharrem	Alla
Dasho	Fetan	Shakaj
Ibrahim	Uk	Aliaj
Vasil	Thoma	Fotiu
Nikoll	Dod	Palaj
Syl	Tahir	Nezaj
Zydi	Mehmet	Leskaj
Enver	Muço	Shaqiraj
Mihal	Koço	Kosta
Nebi	Lymo	Hoxhaj
Gasper	Kole	Shkurtaç
Odhise	Kosta	Çollu
Islam	Hasan	Ibrahimi
Zyhdi	Shaban	Topi
Agim	Hasan	Bylyku
Selam	Riza	Hoxha
Epaminonda	Thoma	Gjukuria
Mustafa	Tahir	Kanda
Xhemil	Asllan	Maskaj
Amir	Bejtash	Xhaxho
Nikolla	Joti	Profi
Sulejman	Sefer	Osmëni
Bajram	Murat	Mejdini (Mejdiu)
Viktor	Nove	Qafa
Tasi	Soti	Çako
Yzeir	Jonuz	Manko
Rustem	Ismail	Beqiri
Arifo (Arif)	Murat	Rexhepaj
Lulo	Izet	Ismaili
Besim	Ibrahim	Lami
Stavro	Jani	Pilafa
Islam	Riza	Luli
Petraç	Dhori	Kote
Avdi	Sadik	Xheladini
Elham	Guro	Shametaç
Rasim	Ramadan	Haxhija
Ismet	Shaban	Sheshori
Muharrem	Bufi	Zenel
Nezir	Seit	Sagajeva
Frano	Bibë	Prendi

EMËR	ATËSI	MBIEMËR
Kastriot	Sala	Shehu
Sulo	Veli	Mullaraj
Hysen	Memet	Sulçe
Dashamir	Refat	Haxhiaj
Mubareq	Muharrem	Mumajesi
Imer	Ahmet	Kukaj
Nazmi	Ahmet	Berisha
Ymer	Adem	Llugaliu
Shaban	Selman	Mara
Bib	Dodë	Gera
Mersin	Dem	Vlashi
Peter	Pali	Ranxha
Gjet	Dodë	Vocaj
Demir	Sulejman	Hysolli
Niko	Polena	Kosta
Vaid	Muharrem	Kapçiu
Pasku	Athanas	Simaku
Baftjar	Sefedin	Shemaj
Boris	Save	Drapa
Spiro	Gogo	Papasava
Haxhi	Met	Myzeqari
Karlo	Loro	Çefa
Jorgji	Nasho	Thano
Thoma	Pano	Çomi
Mehdi	Muhamed	Dakoli
Gjeto	Rrok	Vukcaj
Kiço	Petro	Gjidede
Dylber	Ismail	Zorba
Andon	Dhimiter	Konomu
Fevri	Nexhip	Doko
Mina	Jorgo	Liti
Iljaz	Bejo	Llazaj
Gjovalin	Ndoc	Hejza
Sabri	Islam	Ishmi
Fehim	Feim	Ahmeti
Agron	Kamber	Belishova
Nina	Mihajllav	Pumo
Miho	Koço	Gjini
Imedi	Idris	Biba
Dalip	Abdi	Demirlika
Ndrec	Pjeter	Prenga
Uran	Fuat	Kostreci
Jani	Vasil	Sterio
Petrit	Riza	Sadushi
Feim	Maliq	Salianji
Agim	Ali	Agolli
Prokop	Andon	Mani
Hysen	Ramazan	Tabaku
Ylvi	Brahim	Toro
Musa	Uk	Vokshi
Grigor	Dhimitër	Stoja
Mark	Gjon	Alija
Kristofor	Spiro	Zeno
Hasim	Maksut	Mema
Fejzo	Xhelo	Taka
Njazi	Isa	Toska
Qamil	Haxhi	Haka (Halihakaj)
Qazim	Selim	Hasanraku
Pellumb	Ibrahim	Balani
Subi	Qazim	Qoku
Haki	Riza	Agalliu
Mehmet	Mahmut	Merxho
Mustafa	Maksut	Kurti
Agostin	Mark	Pirol (Preçi)
Gjon	Nikoll	Gjeta
Shuajb	Nuro	Nurja
Skënder	Bajram	Ujka
Shpetim	Dervish	Bisha
Neim	Myrto	Muhaj
Dalip	Hajdar	Zhaboli
Tahir	Hasan	Alija
Selman	Ramazan	Jahja
Ridvan	Izet	Buzo
Viktor	Ligor	Pjetri

EMËR	ATËSI	MBIEMËR
Jorgji	Mitre	Meçi
Shefki	Ibrahim	Çela
Stavri	Aleks	Çuka
Vasil	Kristo	Zoja
Gani	Musa	Sijoni
Maço	Rexhep	Barjamaj
Hysen	Jonuz	Panja
Rustem	Ukë	Berisha
Muço	Lamçe	Bazaj
Gaço	Pandi	Tego
Maksut	Isuf	Xhimaku
Preng	Geg	Nikolli
Hydo	Ali	Qerimi
Belul	Zalo	Alushi
Petraç	Naun	Korçari
Hasan	Bajram	Basha
Niko	Dhimiter	Ajdhoni
Ndreke	Zef	Bozhdari
Spiro	Vasil	Gjikopuli
Luigj	Gjek	Miri
Jorgaç	Ilo	Janko
Petrit	Fuat	Horjeti
Mexhit	Mehmet	Capa
Minella	Miltiadh	Deli
Ndoc	Tom	Daka
Spiro	Xhimo	Lolo
Leopold	Loro	Shkreli
Ëalter	Rexhai	Kosturi
Spiro	Mihal	Zaho
Qemal	Zenel	Limaja
Kolec	Marash	Mirashi
Spiro	Thoma	Kumbuli
Rukie	Ram	Mehmetaj
Ded	Zef	Shkoza (Preni)
Bardhyl	Salih	Morina
Thoma	Thanas	Kacano
Zabit	Maksut	Burnazi
Thanas	Petro	Gulo
Muharrem	Ramazan	Sorra
Ferzi	Sherif	Çekiçi
Agim	Myslim	Noku
Bajram	Ali	Xibraku
Shaban	Izeir	Musaj
Hysen	ramiz	Kuqi
Franko	Dhimitri	Sara
Ali	Ymer	Hoxha
Mark	Preng	Qafa
Shefqet	Shaqir	Gjana
Ferik	Mezan	Jonuzi
Stefan	Miho(Mihal)	Shani
Mehmet	Besim	Taipi
Muharem	Reshit	Ferhati
Sulejman	Abaz	Bajraktari
Dhimitraq	Foto	Stefa
Behar	Shyqyri	Shahaj
Gëzim	Manush	Peshkëpia
Teli	Vangjel	Zhanga
Bahri	Qazim	Marku
Sherif	Qemal	Merdani
Tasim	Rexhep	Cala
Stavri	Kroni	Tashi
Kol	Mark	Ujka
Muharrem	Hekuran	Zenelaj
Latif	Xhemal	Hamja
Tush	Adem	Topuzi
Tahir	Selim	Hamza
Ylber	Fuat	Merdani
Fuat	Bajram	Veliaj
Ahmet	Ali	Abdia
Engjell	Ferik	Fidani
Petrit	Nikolla	Konda
Hasim	Muharrem	Delija
Isuf	Ismail	Meshi
Abduraman	Nuri	Pilkati

EMËR	ATËSI	MBIEMËR
Kadri	Ismail	Ramaj
Esat	Shaqir	Myftari
Kadri	Karafil	Qelibashi
Angjelino	Ylmi	Dyrmishi
Kristo	Hasan	Dervishaj
Skënder	Islam	Demiraj
Kristaq	Koço	Kosta
Xhevat	Bardh	Gjana
Mihal	Jani	Shteto
Dilaver	Xhemal	Hasa
Shpëtim	Enver	Mersini
Esat	Rustem	Elezaj
Seit	Zenel	Xhomaqi
Kujtim	Isuf	Luzaj
Beqir	Dan	Ibraj
Rexhep	Demirsha	Qosja
Ibrahim	Ali	Ibrahimaj
Gëzim	Zenel	Bylykbashi
Sadik	Dan	Peposhi
Shpend	Qerim	Çelaj
Hajrulla	Can	Kruja
Jup	Veli	Rama
Ramiz	Nevruz	Miloshi
Avdulla	Qemal	Hysenaj
Medi	Xhelal	Myslymi
Kostaq	Spiro	Dhima
Demir	Arif	Murrizi
Lefter	Spiro	Papa
Mark	Fran	Dodaj
Pëllumb	Qamil	Xhyheri
Kujtim	Sadik	Metra
Fahrudin	Rifat	Laze
Adem	Jonus	Musaraj
Elez	Uke	Hoxha
Ludovik	Ndok	Vuka
Bardho	Bego	Gjonzeneli
Novrus	Riza	Leka
Vlash	Jorgji	Vava
Muço	Ramadan	Bocaj
Ramazan	Daut	Smajli
Simon	Nikoll	Hyka
Memisha	Muhamet	Gjonzeneli
Arifo (Arif)	Zenun	Lleshi
Mhill	Gjon	Gjinaj
Urim	Resul	Elezi
Anastas	Miti	Lapi
Madrit	Halit	Gjolena
Jakup	Abdyl	Xhejani (Mustafa)
Zyhdi	Hidër	Arapi
Lefter	Jorgji	Musha
Feti	Sali	Lushaj
Dragush	Mehmet	Myftiu
Lazi (Llazar)	Jan (Jani)	Kovaçi
Besim	Hakik	Qoku
Asqeri	Zaim	Hada
Haxhi	Sabri	Qira
Asim	Bisho	Gogaj
Hamdi	Ali	Kaziu
Lazër	Hilë	Hila
Naxhi	Riza	Lami
Astrit	Selim	Xhaferi
Hysen	Zog	Vuçaj
Gjergji	Kostaq	Peppo
Zequir	Latif	Dine
Panajot	Dhimitër	Konini
Fatmir	Hysen	Libohova
Raif	Riza	Topatani
Muharrem	Halit	Rusi
Ramiz	Riza	Tema
Ramadan	Hekuran	Toska
Masihar	Ismail	Paja
Jorgo	Spiro	Papa
Mark	Kol	Shkreli
Thoma	Stavro	Jerondati

EMËR	ATËSI	MBIEMËR
Leka	Hodo	Islambejo
Esat	Hysni	Dedja
Leko	Lluka	Kashta
Lluka	Pavlo	Mëhilli
Hysen	Sali	Bukoshi
Palok	Kol	Vokri
Dhimitraq	Harilla	Pango
Tomorr	Adem	Balliu
Pali	Mani	Ndreçka
Vasil	Thimjo	Gjinopuli
Luan	Xhelal	Muçollari
Pjeter	Preng	Gjoka
Mihal	Jorgo	Kapsalidhi
Mark	Pjetër	Prekducaj
Dhimitër	Koço	Bifsha
Rustem	Bazo	Shahaj
Hajredin	Mustafa	Duka
Petref	Novrus	Hasanaj
Hysen	Abdyl	Xhanija
Pavle (Petro, Pavlo)	Vojo	Popoviç
Gjet	Nikollë	Doda
Fatmir	Shyqyri	Llagami
Fatmir	Sefer	Mujo
Tajar	Selman	Vendresha
Daut	Sadik	Mehmeti
Lekë	Zef	Syku
Zyber	Qazim	Alihmeti
Skender	Abdyl	Shatku
Mitat	Nazo	Agaj
Gani	Abdyl	Qeraxhiu
Ramazan	Ismail	Spahiu
Robert	Gurali	Morava
Mark	Ndue	Ndreka
Jusuf	Ahmet	Dermani
Zef	Dede	Lukaj
Reshat	Tefik	Silaj
Hysen	Ismail	Haxhiaj
Preng	Pal	Gjoka
Hasan	Daut	Misiraj
Halit	Maliq	Zajmi
Thanas	Panajot	Zhidro
Xheladin	Skënder	Zyka
Spiro	Stavro	Rexho
Demir	Hysen	Hasani
Dilaver	Bajram	Gjymenga
Zhifko	Harallamb	Themelko
Ylli	Sadik	Shtylla
Xhevair	Çerkez	Maksuti
Ndue	Vat	Hoti
Kadri	Dine	Thaçi
Haki	Emrush	Hysa
Nikoll	Mark	Marku
Ylli	Ramazan	Tabaku
Luman	Hasan	Kapllani
Andrea	Jorgji	Martino
Klearko	Gogo	Papasava
Zef	Prengë	Ndoj
Krenar	Haki	Kajo
Zek	Tahir	Shala
Dhimitraq	Petro	Harilla
Anton	Gjon	Çefa
Gjon	Frrok	Jaku
Mihal	Thanas	Qafko
Xhevit	Xhaferr	Murrizi
Foto	Nikolla	Qirjazati
Jonuz	Misin	Troci
Gjete	Pjeter	Kadeli
Kosta	Vangjel	Peko
Mirash	Mark	Gjoka
Minello	Petro	Çetri
Ali	Ymer	Nelko
Veip	Ferik	Hoxha
Llesh	Ndok	Ndoj

# U kap brenda në bunker, gjykata liron Alket Hatinë

## Italianët ndoqën nga afër arrestimin por dënimin e ka shlyer në Shqipëri



Alket Hatija

për ardhjen e letërporosisë italiane, për nisjen e procesit gjyqësor të ekstradimit të tij. Më tej prokurori i çështjes tha se disponojnë një vendim të Interpolit, ku Hatia është ende në kërkim ndërkombëtar dhe një vendim gjykatë të drejtësisë Italiane, ku thuhet se ai është dënuar me 20 vite burgim për akuzën e trafikut të heroinës në mënyrë të përsëritur dhe drejtim të organizatave kriminale. Mirëpo, pavarësisht kësaj, avokatët mbrojtës

të Hatisë i thanë gjykatës se klienti i tyre duhet të lirohet pasi këtë dënim e ka shlyer në Shqipëri dhe rezultoni dënuar për të njëjtën veprë penale dhe të njëjtat episode ku dyshohet se ka trafikuar drogë. Sipas avokatëve, nuk mundet që një person të kryejë dy herë dënimin, për të njëjtën veprë penale. Pas dëgjimit të palëve, gjyqtari Petraq Curri ka vendosur të pranojë kërkesën e avokatit mbrojtës, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të

Alket Hatisë nga qelia dhe nxjerjen e të gjitha veprimeve të policisë "Nul".

### APELIMI I VENDIMIT

Mësohet se me këtë vendim nuk ka qënë dakort prokuroria e Durrësit, e cila mësohet se në ditët në vijim të apelojë vendimin e shkallës së parë. Nuk dihet me saktësi se ku do mbështet prokuroria për apelimin e këtij vendimi, por burimet thanë se procedura për rikthimin në qeli të Hatisë do vijojë në Apel.

## I arrestuari

### Media italiane: Bosi i drogës rrinte në bunker



Pas arrestimit pak ditë më parë në Shqipëri të shumëkërkuarit Alket Hatija, mediat italiane kanë zbardhur detaje të reja për 44 vjeçarin, që konsiderohej si një nga bosët më të mëdhenj të trafikut të drogës, që ishte dënuar me 20 vjet burg. "Ansa" shkruan se Alket Hatija fshihej në një vilë bunker në zonën e Beratit dhe lëvizte i rrethuar nga rojet, ndërsa u arrestua në Durrës teksa do të takonte një mik. Sipas medieve italiane, shqiptari në fillim të viteve 2000 kishte trafikuar në qytetin e Milanos rreth 350 kg heroinë e 190 kg kokainë me vlerë 35-40 milionë euro. Sipas hetuesve, ai fliste pak në telefon dhe askush nuk e thërriste kurrë në emër, ndërsa droga vinte nga Shqipëria nëpërmjet anijeve, makinave e kamionëve.

gjykatës që të caktojë masën e 40 ditëve burgim, procedurë kjo standarde që përdoret për rastet e ekstradimit. Sipas prokurorit, Hatia duhet të qëndronte në qeli 40 ditë, kohë kjo që mjafton

ELTON QYNO  
TIRANE

Alket Hatia, njëri nga drejtuesit e grupit të Shijakut, që është provuar se ka trafikuar nga Shqipëria në Itali rreth 488 kg heroinë, është liruar nga gjykata e Durrësit, vetëm tri ditë pasi u arrestua pasi doli nga shtëpia bunker ku banonte në Berat nga Policia e Shtetit. Mësohet se në operacionin për arrestimin e tij kanë asistuar dhe specialist të policisë italiane, dhe ka shumë gjasë që kjo ka sjellë dhe arratinë e izolimin në bunker të Alket Hatis. Megjithatë u arrestua dhe u mbajt tri ditë brenda në polici, në pritje për të dalë para gjykatës, Hatia mesditën e djeshme është liruar nga qelia dhe arrestimi i Policisë së Shtetit është nxjerë "nul". Kjo, pasi, siç mëson "Shqiptarja.com", Alket Hatia është dënuar një herë në Shqipëri në vitin 2009 me 15.4 vite burgim për një sërë akuzash të rënda si "Trafikimit të narkotikeve", të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se njëherë, "Organizimit dhe drejtim të organizatave kriminale" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale". Sipas një vendimi të Gjykatës së Krimeve të Rënda, Hatia është dënuar nga kjo gjykatë për të treja akuzat e sipërcituara, dhe përfundimisht ai është dënuar me 15.4 vite burgim.

### KËRKESA PËR EKSTRADIM

Teksa ka qëndruar 48 orë në ambjentet e policisë së Durrësit, Alket Hatia dje në mesditë ka dalë para Gjykatës së Durrësit, për t'u njohur me masën e sigurisë. Përfaqësuesi i prokurorisë i ka kërkuar

Zjarri  
TIRANE

# Shpëtohen banesat e kisha në Dropull, vatër zjarri në Selenicë

## Situata e zjarreve në vend, ja vatrat më të nxeha

Temperaturat e larta vijnë të jenë të pranishme në të gjithë vendin, ndërsa ka disa vatra zjarri nga veriu në jug. Gjatë orëve të fundit janë evidencuar 7 vatra zjarri në qarkun e Dibrës, Vlorës, Gjirokastrës dhe Elbasanit. Emergjencat Civile vijnë të mbajnë nën vëzhgim situatën përmes specialistëve të saj në qarqe. Neutralizohen 5 vatrat e zjarrit në fshatin Goricë në Dropull, shmanget rreziku për 10 banesa dhe kishën. Pas mbi tri orësh ndërhyrje, zjarrikësja edhe me ndihmën e banorëve kanë arritur që të

shuajnë flakët që rrezikonin banesat dhe kishën. Drejtori i Zjarrfikësës, Kujtim Bizhga në një lidhje me "Report Tv" direkt nga vendi i ngjarjes akuzoi se zjarri ka qënë i qëllimshëm nga barinjët. "Kemi eliminuar djegien e banesave dhe kishës, shpëtuan, janë jashtë rrezikut. Zjarri është vendosur qëllimisht nga barinjët e zonës, që mendojnë vetëm për vete për të djegur kullota" deklaroi ai. Ndërkohë që është zhbllokuar edhe aksi nacional Gjirokastrë -Kakavijë pas

blokimit për rreth 30 minuta nga policia për të shmangur dëme materiale. Ndërkohë rreth 150 ha shkurre dhe kullota janë djegur në fshatin Mavrove të bashkisë Selenicë. Prej dy ditësh zjarri ka përfshirë kullotat dhe shkurret në faqet malore, cka solli edhe rrezikimin e qindra rrënjë ullinj. Rreth 20 forca zjarrfikëse dhe dy automjete kanë izoluar zjarrin dhe vijnë punën për shuarjen e plotë. Nga të dhënat e fundit, zjarri nuk rrezikon banesat.



### NE KORÇE

## Digjen 120 bimë drogë, punohet për kapjen e autorëve



120 bimë të dyshuara Cannabis Sativa janë asgjësuar nga policia në Korçë. Zbulimi dhe asgjësimi i bimëve narkotike u bë gjatë një kontrolli të ushtruar në fshatin Voskopojë, pranë vendit të quajtur "Përroi i Qershisë". Bimët narkotike u dogjën nga policia, ndërkohë po punohet për identifikimin, kapjen e autorit/ëve si edhe dokumentimin e plotë të ngjarjes. Materialet i kaluan Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Korçë, për veprën penale: "Kultivimi i bimëve narkotike".

### NE PORT

## Tenton të korruptojë olicin e kufirit, pranga turkut



Në mungesë të një vize për të udhëtuar nga Shqipëria drejt Italisë, një shtetas turk 32-vjeçar, ka tentuar të korruptojë policin e kufirit në portin e Durrësit. Në pranga ka përfunduar Mursel Dagli, 32 vjeç, pasi në brendësi të pasaportës së tij, vendosi 100 euro, në mënyrë që polici i kufirit ta lejonte të udhëtonte drejt Italisë. Materialet për këtë rast i kanë kaluar Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për veprime të mëtejshme, ndërkohë 32-vjeçari i rëndojnë veprat penale "Korrupsioni aktiv i personave që ushtrajnë një funksion publik" dhe "Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror".

# Kokainë në Xibrakë, 104 vite burg grupit, 10 vite Ermal Hoxhës

## Gjykata mbyll gjykimin e bandës së Kokainës. Akuza kërkoi 126 vite burgim

ELTON QYNO  
TIRANE

Gjykata e Krimeve të Rënda ka dhënë 104 vite burg për grupin kriminal të trafikimit të kokainës, i njohur si grupi "Xibraka". Ermal Hoxha, nipi i ish-diktatorit Enver Hoxha është dënuar me 10 vjet burg, 13 vite burg kanë shkuar për Saimir Batku, ndërës dy kolumbianët Cezar Avila dhe Ëalter Moreno janë dënuar të dy me nga 12 vite burg. Organizatori dhe financuesi i grupit të kokainës, Genc Xhixha është dënuar në mungesë me 13 vite burg. Xhixha njihet si një nga kokat e trafikut të kokainës në Europë dhe më gjerë në Amerikën Latine. Prokuroria kërkoi 126 vite burg për anëtarët e bandës, ndërsa gjykata reduktoi dënimet me 12 vjet. Grupi i trafikut të drogës u zbrëthye në janar të 2015-ës, gjatë një operacioni të policisë me ndihmën e prokurorëve gjermanë, në fshatin Xibrakë të Elbasanit, ku u zbulua magazina e drogës, ndërsa u sekuestruan 100 kg kokainë.

### VEPRAT PENALE

Një vit e dy muaj hetime i kanë mjaftuar Prokurorisë së Krimeve të Rënda, që të faktotë akuzat ndaj 8 të pandehurve të dosjes "Xibraka", ku i pandehur është marrë dhe Ermal Hoxha nipi i ish-diktatorit Enver Hoxha. I pandehur është marrë dhe biznesmeni Gentjan Gjonaj, ky i fundit një ish-ndërtues në Vlorë, tashmë i falimentuar dhe ish-bashkëaksioner me dhëndërin e Enver Hoxhës. Hetimet ndaj këtij grupi fillimisht kanë nisur nga autoritetet e prokurorisë së Hanoverit në Gjermani, por për shkak se grupi kishte dhe anëtarë të tjerë në Shqipëri, Gjermanëve në muajin Janar 2015 i është dashur të vizitohet vetë Shqipërinë, ku kanë kërkuar ndihmë nga policët



Laboratori i drogës në Xibrakë

dhe prokurorët shqiptarë. Operacioni është kryer në fshehtësi të plotë, duke arritur të arrestohen personat kryesorë të këtij rrjeti, ndërkohë vetëm njëri Genci Xhixha, është shpallur në kërkim, pasi siç mësohet ai jeton në Amerikën Latine. Pak ditë më parë, 8 të pandehurve u janë komunikuar akuzat e "Trafikut të lëndëve narkotike" kryer në kuadër të "Grupit të Strukturuar Kriminal" dhe "Armëmbajtje pa lejë".

### EKSPERIMENTI

Dy kolumbianët e pandehur Cesar Avila dhe Ëalter Moreno gjatë hetimeve janë çuar në laboratorin e kokainës

në Xibrakë të Elbasanit, për të performuar në prezencë të anëtarëve të grupit hetimor, se si arrinin të veçonin kokainën nga pjesa e lëngshme dhe rrobat e fëmijëve që vinin nga Turqia. Ky process sipas prokurorëve është kryer, për të mësuar më nga afër procedurën e plotë se si dy kolumbianët, arrinin të nxirnin kokainën e pastër, duke e kthyer atë nga gjëndja e lëngshme në gjëndje të ngurtësuar dhe të gatshme për tu konsumuar. Ndërkohë për dy kolumbianët e arrestuar të këtij grupi kriminal, në Tiranë pak ditë më parë mbëritën dhe dy prokurorë Kolumbianë, për të mësuar rreth aktivitetit të tyre. Ndërsa i pandehuri Ilir

### TRANSPORTI

Kolumbinët transportoheshin me makinë për në Xibrakë nga Ermal Hoxha, i cili pas arrestimit deklaroi se punonte si taksist.

### 300 MIJË EURO

Gjatë operacionit "Xibraka" krahas sekuestrimit të 20 kg kokainë dhe shumës prej rreth 300 mijë eurove kesh.

Hyseni ishte personi që do përdorej si korrier së bashku me të dashurën e tij Pranvera Ebellin, ku pas verifikimeve të shumta prokuroria konstatoi se kjo e fundit ka mbëritur në Shqipëri me Hysenin dhe më pas është larguar në Gjermani. Ebellin u ndalua në Gjermani dhe pas marrjes në pyetje, ka rezultuar se ajo nuk kishte dijeni. Gjatë operacionit "Xibraka" krahas sekuestrimit të 20 kg kokainë dhe shumës prej rreth 300 mijë eurove kesh, ekspertët e policisë shkencore kanë konstatuar se në solucionin kimik që ndodhet në rreth 50 fuçit e hekurit, të cilat u gjetën brenda magazinës së transformuar në laborator, ka



Ermal Hoxha

### DËNIMET E GJYKATËS

■ Ermal Hoxha	10 vjet burg
■ Arjan Dalipi	10 vjet burg
■ Cezar Avila	12 vjet burg
■ Ilir Hysenaj	12 vjet burg
■ Saimir Batku	13 vjet burg
■ Klement Dalipi	11 vjet burg
■ Genci Xhixha	13 vjet burg
■ Gentjan Gjonaj	11 vjet burg
■ Ëalter Moreno	12 vjet burg

kokainë. Sasaia e drogës vinte nga Kolumbia me traget dhe fshihej në kontinjerë, duke u tretur në vajra të ndryshëm. Më pas grupi, në një magazinë të vjetër në Xibrakë të Librazhdit, kryente procesin e nxjerrjes së kokainës, ku për këtë qëndronin në Tiranë dy kolumbianët. Ata transportoheshin me makinë për në Xibrakë nga Ermal Hoxha, i cili pas arrestimit deklaroi se punonte si taksist.

### NË KËRKIM NGA KANADAJA

Ilir Hyseni, njeriu që u kap brenda në laboratorin e kokainës në Xibrakë të Elbasanit, rezultoi si person i shpallur në kërkim ndërkombëtar dhe


se fotoja e tij është publikuar në faqen zyrtare të interpolit. Në kërkim ai rezultoi të jetë me emrin Bali Meta, dhe se janë autoritetet kanadeze dhe jo amerikane, ato që kanë lëshuar urdhërin e arrestit ndërkombëtar për akuzat e "Falsifikimit të pasportave", "Grupit të strukturuar kriminal", "Posedimit të armëve të zjarrit" dhe "Trafikut të kokainës". Shpallja në kërkim e Bali Metës është kryer që prej nëntorit të 2009, kohë kjo kur autoritetet kanadeze kanë zbuluar se Ilir Hyseni allias Bali Meta, kishte ngritur një laborator në Toronto, ku falsifikonte pasaporta amerikane.

## ARRESTOHET NJËRI NGA AUTORËT E PLAGOSJES

# Lezhë, qëllloi me armë shoferin dhe tentoi të ikte në Kosovë, kapet

Policia ka vendosur në pranga njërin nga autorët e plagosjes mëngjesin e djeshëm në fshatin Kalivaç, ndërsa tjetri është ende në kërkim. Gjovalin Voci (Samuel Feta) 40 vjeç banues në Kalivaç sot në mëngjes qëlloi me armë zjarri së bashku me një tjetër person Aleksander Gjonocën 47-vjeç. Shoferi i furgonit të pasagjereve të linjës Kalivaç-Lezhë është plagosur në këmbë dhe më pas është dërguar në spital dhe ndodhet

jashtë rrezikut për jetën. Ndërsa Gjovalin Voci (Samuel Feta) pas ngjarjes është larguar në drejtim të doganës së Kukësit me qëllim për të kaluar në Kosovë, por u arrestua. Sipas policisë ngjarja ka ndodhur pas një sherri mes dy personave, ndërsa po punohet për sqarimin e plotë të rrethanave. Në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale automjeti i shtetasit të dëmtuar si dhe tre gëzhoja armë zjarri.



## NGJARJA NË TIRANË

### Vodhën energjinë elektrike në pranga 2 persona

Dy persona janë arrestuar nga policia e Tiranës pasi kanë vjedhur energjinë elektrike. Policia bën me dije se në pranga ranë 31 vjeçari me inicialet Y.K dhe K.T. Arrestimi i tyre u bë pasi në banesën e tyre janë konstatuar lidhje të paligjshme të energjisë elektrike. Në një njoftim të uniformave blu thuhet: "Më datë 10.07.2017, shërbimet e policisë kanë arrestuar në flagrancë për veprën penale të "Vjedhjes së Energjisë elektrike" shtetasit: - K. T. dhe Y. K., 31 vjeç, banues në Tiranë". Arrestimi i këtyre shtetasve u bë pasi në banesë janë konstatuar ngapunjësit e OSHEE lidhje të paligjshme të energjisë elektrike. Vazhdon puna për goditjen e paligjshmërisë dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve të veprave penale", vijon më tej njoftimi i Policisë.

# Dosja e doganjerëve të akuzuar për drogë do hetohet në Durrës

## Shfryhet operacioni për arrestimin e doganjerëve, për kamionin me 8 ton drogë

ELTON QYNO  
TIRANË

Kanë marrë një tjetër kthesë hetimet për dosjen e trafikut të 8 tonëve kanabis, që mundi të transportohej nga një shtetas maqedonas nga Shqipëria në drejtim të Italisë. Për 11 punonjësit e portit të Durrësit, prej nga ka kaluar pa u vënë re nga askush kamioni me 8 tonë drogë, është shpallur moskompetenca nga Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe momentalisht dosja në ngarkim të tyre i është referuar prokurorisë së Durrësit për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës". Prej pesë muajsh, Krimet e Rënda kanë kryer një sërë veprimesh hetimore me qëllim sigurimin e provave që do të vërtetonin implikimin e doganierëve të Durrësit në trafikun e drogës. Por gjatë kësaj kohe është konsideruar se ata nuk janë të implikuar në trafikun e drogës dhe për pasojë, çështja ndaj tyre i është përcjellë prokurorisë së Durrësit, e cila do të vijojë hetimet për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës".

### ARRESTIMI DHE LIRIMI

Me urdhër të Prokurorisë së Krimeve të Rënda në muajin prill 2017 janë arrestuar 18 persona, mes tyre dhe shefi i postës policore në Portin e Durrësit, Julian Doraci. Në pranga kanë përfunduar 10 punonjës policie në Portin e Durrësit, përfshirë edhe shefin e stacionit policor, si edhe 8 doganierë të Qafë-Thanës, Durrësit e Tiranës, të dyshuar se kanë siguruar kushtet për kalimin e dy ngarkesave të ndryshme, me vlerë totale 10.2 ton kanabis sativa nga Shqipëria në Itali, në muajt shkurt dhe mars 2017. Për të gjithë këta persona, Prokuroria për Krime të Rënda në atë kohë krijoi dyshime të arsyeshme se kanë konsumuar elementët e veprës penale të "Trafikut të narkotikëve", në bashkëpunim. Për këtë arsye, me kërkesë të Prokurorisë, Gjykata për Krime të Rënda ka caktuar masën e sigurimit "arrest me burg", të cilat u zbatuan nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme, si edhe Policisë së Shtetit. Por disa muaj më vonë ka qënë Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, ajo që ka ndryshuar masat e sigurisë për të arrestuarit, duke lënë pjesën më të madhe të tyre të lirë.

### SHOFERI DHE KAMIONI NUK U FUT NË TIMS

Nga këqyrja e librit të shërbimit të

### PUNONJËSIT E PROCEDUAR

- Gëzim Dervishi, specialist në Policinë e Portit Durrës
- Mexhit Xhixha, specialist, struktura anti-drogë, Policia e Portit Durrës
- Roland Metani, specialist, struktura anti-drogë, Policia e Portit Durrës
- Agron Kapllani, specialist, struktura anti-drogë, Policia e Portit Durrës.
- Gentian Selmani, specialist, struktura anti-drogë, Policia e Portit Durrës
- Medi Demiri, kontrollor, Policia e Portit, Durrës
- Fatmir Plaku, kontrollor, Policia e Portit, Durrës
- Julian Doraci, Shef i Stacionit Policor, Porti Durrës
- Edmond Luzi, doganier eksporti, Porti Durrës
- Behar Sula, kontrollor hyrje-dalje, Policia e Portit, Durrës
- Nezir Bardhoshi, kontrollor hyrje-dalje, Policia e Portit, Durrës.



Julian Doraci

### → JO NË TIMS

Punonjësi i policisë, Fatmir Plaku, i cili ka qënë personi përgjegjës për të bërë regjistrimin e automjetit në sistemin TIMS, e ka lejuar automjetin të kalojë për në Itali pa verifikuar hyrjen e shtetasit të huaj në Shqipëri që drejtonte automjetin të ngarkuar me lëndë narkotike, shtetasi maqedonas, Z.S.

automjeteve me lëndë narkotike nga Porti Durrës për në Itali, me datë 5 shkurt 2017 kanë qënë me shërbim punonjësit e policisë të gupit të kontrollit, shtetasi Gëzim Dervishi, me detyrë specialist i trajtimit të qenve

punonjësve të policisë që kanë qënë me shërbim në Stacionin e Policisë Portit Durrës, në kohën e daljes së dy

## Ngjarja në Pogradec Tenton të vrasë me thikë një 28-vjeçar, ndërhyjnë policia

Agjentët e krimeve në komisariatit e policisë së Pogradecit kanë bërë të mundur paraditen e së martës parandalimin e përshkallëzimit të një konflikti mes dy personave. Burime nga policia lokale bëjnë me dije se në pranga ka rënë 24-vjeçari Mario Xhangolli, i cili ishte në zotërim të armëve të ftohta dhe kishte sulmuar një person tjetër 28-vjeçar me inicialet F.M. Policia sqaron se: "Ngjarja dyshohet të ketë ndodhur pasi shtetasit e mësipërm, janë konfliktuar me njëri-tjetrin, si pasojë e përplasjes me dëme materiale, të dy automjeteve konkretisht njëri me drejtues shtetasin F.M dhe tjetri me drejtues babain e shtetasit Marjo Xhangolli, në rrugën nacionale Pogradec-Korçë"-thuhet në njoftimin e policisë. Policia ka sekuestruar në cilësinë e provës materiale, armën e përdorur nga Xhangolli. Materialet për këtë rast i janë referuar Prokurorisë për veprën penale "Vrasje me dashje e mbetur në tentativë".



të shërbimit, Mexhit Xhixha, Roland Metani, Agron Kapllani, Gentian Selmani, me detyrë shoqërues qeni antidrogë, Medi Demiri, kontrollor, Fatmir Plaku me detyrë ndihmës/specialist kontrollor. Ndërsa Shefi i Stacionit të Policisë Portit Durrës ka qënë shtetasi Julian Doraci. Nga deklaratimet e punonjësve të policisë kufitare tek Stacioni i Policisë Porti Durrës, si dhe nga provat e tjera të administruara, nuk rezulton që ata të kenë ushtruar kontrollin e automjetit kamion me targa maqedonase, me datë 5 shkurt 2017, në kohën kur ai ka dalë i ngarkuar me lëndë narkotike nga Porti Durrës për në drejtim të Italisë. Punonjësi i policisë Fatmir Plaku, i cili ka qënë personi përgjegjës për të bërë regjistrimin e automjetit në sistemin TIMS, e ka lejuar automjetin të kalojë për në Itali pa verifikuar hyrjen e shtetasit të huaj në Shqipëri që drejtonte automjetin të ngarkuar me lëndë narkotike, shtetasi maqedonas, Z.S, edhe pse nuk është i regjistruar në hyrje nga punonjësi i policisë kufitare të Pikës së Kalimit Kufitar Qafë Thanë, Pogradec. Nisur nga veprimet e punonjësve të policisë kufitare, të doganës dhe të agjentëve doganorw Qafë Thanë dhe atyre të Portit Durrës dhe Doganës Durrës, del në pah mjaft mirë bashkëpunimi mes tyre për të realizuar kalimin e automjetit kamion të mbushur me lëndë narkotike nga Shqipëria në Itali.

### NUK KONTROLLUAN MJETIN ME DROGË

Nga këqyrja e librit të shërbimit në Doganën Durrës, rezultojnë se me

datë 5 shkurt 2017, në kohën kur ka dalë automjeti kamion me targa maqedonase, nga Durrësi në Itali, i ngarkuar me lëndë narkotike, në atë kohë si doganier i kontrollit të eksportit në Durrës ka qënë shtetasi Edmond Luzi, i cili nuk e ka kontrolluar automjetin, por ka kontrolluar vetëm dokumentacionin e tij që ishte përgatitur nga doganierët e Qafë Thanës, nga ku është dukur qartë edhe devijimi i destinacionit të daljes së tij nga Dogana e Hanit të Hotit për tek Dogana e Durrësit, fakt ky që përbën një shkak rrisht për kontrollin e detyrueshëm të automjetit me mall të ngarkuar në të. Nga rrethanat e mësipërme, rezultojnë se automjeti kamion me targa maqedonase, ka hyrë nga Maqedonia në Shqipëri i ngarkuar me lëndë narkotike, i cili ka kaluar pa ju nënshtruar kontrollit nga punonjësit e policisë kufitare që kanë qënë me shërbim në atë kohë si dhe duke u munduar që të fshehin gjurmët e dokumentimit të hyrjes duk mos e bërë regjistrimin e këtij kamioni. Në rolin e bashkëpunimit të këtij aktiviteti kriminal të trafikimit të lëndës narkotike kanë qënë edhe dy agjentët doganorw Maliq Kadilli dhe Kastriot Topalli, të cilët kanë ndihmuar për ndjekjen e procedurës për devijimin e destinacionit të daljes së automjetit kamion me lëndë narkotike nga Porti Durrës duke patur bashkëpunimin e doganierëve të Doganës Qafë Thanë dhe Durrës dhe të punonjësve të policisë kufitare për trafikimin e lëndës narkotike nga Durrësi për në Itali.

## Seanca në 18 korrik

### Shtyhet seanca kundër Shullazit shkak mungesa e dy gjyqtarëve

Shtyhet Gjyqi për Emiljano Shullazin. Gjykata e Krimeve të Rënda ka vendosur shtyrjen e seancën pasi mungonin 2 prej gjyqtarëve. Në këtë seancë kanë qënë të pranishëm Emiljano Shullazi dhe të akuzuarit e tjerë për gjobënie, grup të strukturuar kriminal dhe një sërë akuzash të tjera. Në seancë pritej të dëshmonin disa prej dëshmitarëve, mes tyre edhe Neshat Fana, ish avokati i Sali Berishës. Ai ishte i pranishëm në Gjykatën e Krimeve të Rënda, por nuk mori pjesë në seancë. Ndërkohë në seancën e radhës Gjykata pritet të thërrasë si dëshmitarë edhe ish-kreun e Hipotekës Ilirjan Muho. Në këtë seancë Emiljano Shullazi dhe të akuzuarit e tjerë nuk kanë folur para trupit gjykues, ndërkohë që një javë më parë u bë ballafaqimi mes Ilvi Beqajt dhe të akuzuarve e tjerë.



Emiljano Shullazin



## Vox Baroque në Shqipëri, Enrica Mari rikthen shpirtin e muzikës së '500-s

*Inva Mula: Ishin vërtetë këngë shumë të bukura, më sollën nostalgji, e më bënë edhe të reflektojë*

**B**aladat e vjetra dhe këngët napolitane janë rikthyer këtë herë në oborrin e Ambasadës Italiane në Tiranë në kuadër të festivalit Vox Baroque që e ka nisur udhëtimin nëpër Shqipëri, që nga data 2 korrik. Festivali përfundon të martën në mbrëmje, në Galerinë kombëtare të Arteve

Finestra bassa, një këngë popullore italiane e vjetër, e viteve 1500, me autor anonim dhe që është kënduar fillimisht me një lloj lahute, por e përpunuar në kohë për instrumente si mandolina, pianoja e më gjerë ka mbetur një perlë e muzikës, falë kompozitorëve të shquar italianë.

Sopranoja italiane Enrica Mari, anëtare e Ansambllit Festa Rustica që ka publikuar edhe albume me këngët napolitane të viteve 700 solli në skenë të gjithë forcën e pasionit dhe dashurisë napolitane.

Ambasadori i Italisë Alberto Cuttillo para se të niste ky festival foli për rrugëtimin të muzikës napolitane, nga ajo e baladave, këngëve të dashurisë e maktheve të xhelozisë që udhëtuan mes melosid dhe dramave të jetës për të krijuar në vitet 700 muzikën barok që nisi në Napoli. Janë këto këngë plot mesazhe dashurie, siç është "La Farfallina" kënga për fluturën me-



Inva Mula

sazhere të dashurisë.

Sopranoja e njohur Inva Mula e pranishme në këtë festival flet për magjinë e këtyre këngëve që kanë hedhur edhe themelet e operës botërore

Është një program unik. Nuk e kemi dëgjuar. Besoj ka qenë një zgjidhje shumë e mençur dhe shumë e rafinuar e drejtorit artistik të festivalit, Jusuf Beshiri. Të përziesh muzikën barok të viteve 1500-1600-1700 me këngët napolitane, ku vërtet Napoli ka patur një traditë të jashtëzakonshme në muzikë. E tregon që çdo gjë e ka

zanafillën tek melodija. E ka zanafillën te kënga e thjeshtë, e ka te melosi i popullit. Dhe, ishin vërtetë këngë shumë të bukura, që të ndërthurura me sonatat e Scarlattit sillnin një freski muzikore, e cila më solli nostalgji, por më bëri edhe të reflektojë", shprehet sopranoja Mula. Për sa i përket reflektimit të sopranos Mula, është një lidhje me kujtesën e saj për rrugëtimin e këngëve shkodrane, një udhëtim i ngjashëm me këngët napolitane që shkuan drejt muzikës së përpunuar. "Pikërisht unë atë do thoja, kënga është melosi i thjeshtë, si ajo që kemi dhe ne në këngët e veriut, që është repertitiv gjithë kohës siç janë këngët napolitane. Po e bukura ishte që këto këngë ishin në gjuhë napolitane, që është një gjuhë antike që nuk flitet sot", shprehet sopranoja e njohur Inva Mula, e cila e nisi shkëlqimin e karrierës së saj, në Itali, pikërisht ku e kanë zanafillën edhe këto këngë", shprehet sopranoja

Sopranoja italiane Erika Mari dhe pianisti Jusuf Beshiri kanë përcjellë për publikun mes duartrokitjeve edhe tarantelën e famshme "Michela mia".

Kjo është një nga ariet më të bukura popullore italiane me zanafillë para pushtimeve turke. Është kënga që tregon për një vajzë të lindur në mes të detit.

### KURATOR GENTI TAVANXHI

## Artistë nga Azia çelin Simpoziumin e Skulpturave të Parkut në Korçë

**K**a nisur në qytetin e Korçës edicioni i 8-të i Simpoziumit Skulptura e Parkut 2017. Këtë herë simpoziumi vjen me një koncept të veçantë, duke i sjellë Korçës frymën Aziatike të gdhendjes së gurit.

Festivali do të zhvillohet rreth 12 ditë, ndryshe nga herët e tjera që është mbajtur vetëm në 5 ditë. I organizuar për tetë vjet me radhë nga Bashkia e Korçës, ky festival i ka sjellë qytetit deri më sot rreth 50 skulptura nga artistët e vendeve të ndryshme të Europës dhe të Botës. Këto skulptura janë vendosur në parkun e qytetit. Ndërsa në edicionin e këtij viti marrin pjesë pesë skulptorë dhe katër arkitektë që vijnë për herë të parë në Korçë. Sipas kuratorit, Genti Tavanxhi në këtë festival bashkëpunojnë për herë të parë



skulptorët me arkitektët. Kjo bëhet "për të treguar vlerat e kulturës së këtij qyteti", thotë Tavanxhi. Xhena Li, skulptore nga Koreja e Veriut vjen për

herë të parë në Korçë. Ajo shprehet se është e emocionuar nga ky qytet dhe e ka të lehtë të ambientohet me veprat që i përshtaten parkut të tij.

### TEATRI "PETRO MARKO"

## "Dy krisma në Paris", studentët e Vlorës rikthejnë dramën e njohur

**D**"y krisma në Paris", drama që është bërë kohë më parë me skenar të Pëllumb Kullës dhe Sheri Mitës rikthehet pas 30 vitesh në skenë nga studentët e Universitetit "Ismail Qemali" në Vlorë. Kjo dramë, për të cilën studentët kanë punuar së bashku me pedagogët e tyre, katër muaj rresht është shfaqur në Teatrin Petro Marko në Vlorë, e ndjekur me duartrokitje nga spektatorët në një sallë të tejmbushur. Në rolin kryesor, atë të Avni Rustemit, studenti Gentian Këllciu përcolli emocione të shumta mes spektatorëve, ndërsa një paraqitje mjaft të mirë bënë edhe aktorët e tjerë të kësaj trupe.



Në fund ka vend edhe për vleresime dhe emocione. Aktortë e rinj marrin një certifikatë mirënjohjeje nga rektori i Universitetit të vlorës, Roland Zisi. Drama "Dy krisma në Paris" që trajton vrasjen e tradhtarit të vendit Esad Pashë Toptani nga Anvni Rustemi, e luajtur nga aktorët e rinj të do të udhëtojë edhe drejt qyteteve të tjera të vendit.



ADMIRINA PEÇI  
TIRANE

**77** vjet më parë, ndër-  
sa Tirana s'kishte  
veçse pak vite që  
ishite shpallur  
kryeqytet, në sho-  
qërinë shqiptare disi të prapambetur,  
të fundviteve '20, do të niste të depër-  
tonte një dritë e re zhvillimi e kulture.  
Ishte viti 1930, kur në sheshin ku sot  
gjendet "Ushtari i panjohur", u hap  
një librari me emrin "Argus". Prej saj  
do të dilnin çdo ditë intelektualët e  
kohës me botimet më të fundit nëpër  
duar, ardhur nga Italia, Franca, Ru-  
mania e gjetkë. Kështu "Argus" do të  
shndërrohej vit pas viti në një dritare  
që përhapte dritën e botimeve perën-  
dimore, e ca vite më vonë edhe idetë e  
para komuniste.

Dhimitër Canco, një intelektual,  
aktivist shqiptar në Konstancë të Ru-  
manisë për plot 10 vjet, një gazetar i  
spikatur i fundviteve '20- dhe i viteve  
'30, e hapi librarinë "Argus", duke e  
njohur mirë fuqinë e librit dhe kul-  
turës që po depëronte fuqishëm në  
Shqipërinë e asaj kohe. Në librarinë  
e tij do të vinin rregullisht botimet më  
të mira të shtëpive botuese italiane e  
franceze, mes tyre edhe e famshmja  
franceze "Hachette". Ende sot në  
familjen Canco ruhet korrespondenca  
me këto botues të njohur perëndimor  
me të cilët Dhimitër Canco shkëmbente  
mendime, e shtronte kërkesat e tij për  
nevojat e librarisë.

"Argus" njohu kulmin e vep-  
rimitarisë së saj në fund të viteve '30-të,  
por edhe gjatë viteve të luftës. Ndërsa  
me vendosjen e regjimit komunist në  
Shqipëri në vitin 1945, e alternuar edhe  
me seksionin e botimeve me logon e  
saj, "Argus" do të njihete pak nga pak  
fundin e aktivitetit të saj, derisa regjimi  
komunist do ta mbyllte përfundimisht  
librarinë e famshme e do ta konfiskonte  
te gjithë titujt e saj.

Sot në familjen Canco ruhen shumë  
gjurmë të aktivitetit të gjerë të kësaj  
librarie, por edhe shumë relike me vlera  
të veçnata e letërkëmbime të Dhimitër  
Cancos. Në këtë intervistë me nipin  
e Dhimitër Cancos, arkitektin Zhani  
Canco do të zbulojmë për lexuesit  
dimensionin e plotë të aktivitetit të  
librarisë "Argus", e cila i pajiste blerësit  
e saj me kupon për uljet, që në fillim  
të viteve '30-të.

**Z. Canco, si nis historia e librarisë  
"Argus"?**

Këtë vit mbushen 77 vjet nga dita  
kur u hap për herë të parë libraria  
"Argus". U hap më 1930 nga Dhimitër  
Canco, vëllai i Mësuesit të Popullit  
Gjergj Canco (babai im).

**Kush është Dhimitër Canco? A mund  
të na bëni një përmbledhje të jetës dhe  
aktivitetit të tij?**

Xhaxhai im Dhimitër Canco ka lin-  
dur më 25 maj 1904 dhe është larguar  
nga jeta më 14 qershor 1990. Jeta e tij  
përmbledhet në shek. XX. Ka lindur në  
shek. XX dhe është larguar nga jeta në  
shek. XX. Në kohën kur u hap libraria  
"Argus", Tirana nuk kishte shumë kohë  
që ishte bërë kryeqytet. Por, kjo nuk  
e pengoi Dhimitër Cancon që të vinte  
nga Rumania, ku kishte qëndruar  
rreth 10 vjet, dhe të hapte të parën  
librari në Shqipëri, të emërtuar "Ar-  
gus". Ai kishte qëndruar në Konstancë  
ndërkohë që komuniteti shqiptar i  
këtij qyteti shënonte hapa përpara  
në udhën e veprimtarive të ruajtjes  
së nacionalitetit të shqiptarizmit dhe

# DHIMITËR CANCO

## SI U HAP LIBRARIA E PARË "ARGUS", KU SHPERNDAHEJ KUPON QË NË 1930

**Intervistë me arkitektin Zhani Canco, nipin e Dhimitër Cancos, ku rrëfen shumë sekrete nga aktiviteti i pazakontë i kësaj librarie që sillte në tiranë botimet më të vyera nga perëndimi.. Aktiviteti i saj deri në vitet e pasluftës, kur me instalimin e regjimit komunist të gjithë librat, periodikët e mjetet didaktike iu konfiskuan...**



Dhimitër Canco, Lasgush Poradeci dhe Mitrush Kuteli Tirane 1937

të çështjes shqiptare, që lidheshin me  
shkollimin shqip dhe të kulturës kom-  
bëtare shqiptare. Prandaj, nuk është  
e rastit që, në këtë qytet, botohej, që  
më 10 dhjetor 1919, gazeta "Shqipëria  
e Re", me kryeredaktor publicistin e  
shquar Guri Malësori (Gjergj Bubani).

**Cili ishte aktiviteti artistik e patri-  
otik i Dhimitër Cancos dhe miqve të tij  
shqiptarëve në Konstancë?**

Në Bashkinë e Konstancës u zhvil-  
luan një sërë veprimtarish kulturore,  
artistike e sportive, të gjitha të brum-  
sura me ndjenjën e dashurisë për vlerat  
e përsosura arbërore. Përveç këtyre, në  
vitet 1922-1923 në Konstancë botohej  
edhe një fletore për nxënësit e shkollave,  
ku në ballinën e saj ishte shtypur  
në mënyrë kuptimplote portreti i Naim  
Frashërit.

Duke u nisur nga gjysma e viteve  
20-të dhe më tej, gjallëria e shqiptarëve  
u duk më shumë në veprimtaritë kul-  
turore e, posaçërisht, në ato artistike

në vitin 1931 bëri disa festivale artistike,  
ku përfshiheshin pjesë teatrore, muz-  
ikore dhe artistike të artistëve shqiptarë  
dhe rumunë. Festalet ndiqeshin  
me kënaqësi nga qindra spektatorë  
shqiptarë. Ishte ky një kontribut në  
kulturën shqiptare dhe në vetë  
ruajtjen e zhvillimin e gjuhës  
shqipe në gjirin e shqiptarëve  
të mërguar. Këto festivale,  
duke u zhvilluar në gjuhën  
amtare të botës shpirtërore  
të mërgimtarëve, gjithnjë  
të malluar për gjithç-  
ka që i mbante gjallë  
si kombësi më vete,  
në njëfarë mënyre  
ishin edhe shkolla  
të shqipes dhe të  
shqiptarizmit.


Në gazetën  
"Shqipëria e  
Re" ka pun-  
uar si reda-  
ktor deri në vitet  
30-të, duke botuar arti-  
kuj politikë dhe ekonomike,  
Dhimitër Canco me pseudonimin  
Morava dhe Toska.

**Ku ndodhej libraria "Argus"?**

Libraria "Argus" ndodhej jo shumë  
larg shkollës amerikane që drejtohej  
nga Harri Fullci në Tiranë, aty ku sot  
është shkolla ekonomike, që më vonë  
iu dha emri Shkolla Teknike-Elektrike  
"Gjergj Canco". Më vonë u largua nga  
ai oborr, ku Gjergj Canco për herë të  
parë dha mësim në vitet 1932-1933,  
së bashku me Harri Fullcin. Oborri  
përbëhej nga godina mësimore, ofiçina  
dhe konvikti. Pra, këto ishin të për-  
mbledhura në këtë oborr, që u hap për  
herë të parë më 1921 me Kellin, Hero-  
din, më vonë më 1922 ka ardhur Harri  
Fullci si drejtor dhe ka qëndruar deri  
më 1933. Në kuadrin e ristrukturimit  
të shkollave, u largua më 1933 nga

Shqipëria.  
Dhe hapja e  
librarisë "Argus" më  
1930 u mirëprit nga dre-  
jtori i  
shkollës sepse ajo ishte një ndihmesë  
për nxënësit e shkollës sepse ata do  
të njiheshin me shumë shkrimtarë  
të njohur amerikanë dhe anglezë. Po  
ashtu, në atë librari do të gjenin lapsa,  
stilografë e mjete të tjera mësimore, të  
markave më të mira, siç ishin ata të  
markave "Pelikan" dhe "Monblanc"  
të cilët u ekspozuan për herë të parë  
në librarinë "Argus".

**Libraria Argus i pajiste blerësit e saj  
me kupon që në fillim të viteve '30-të.  
Si funksiononte?**



Flamuri amerikan  
me 48 vje i ruajtur  
në nje senduk nga  
Dhimitër Canco  
nga 19456 deri  
me sot, prone e  
familjes Canco

# FLAMURI AMERIKAN ME 48 YJE, SI E RUAJTI NE SENDUK QE NGA 1945

Miqësia me Harry Fultzin dhe historia e flamurit amerikan të cilin e ruajti në një senduk deri kur vdiq më 1990

tiranës me qira, ishte e gjatë rreth 10 metra dhe e gjerë rreth 4 metra. Në të dyja anët kishte libra, në fund fare ishte banaku ku bëhej pagesa. Sendet e vendosura ishin libra, stilografë, fotografi. Librarianë e vizitonte çdo turist i huaj që vinte në Tiranë, ambasadat e akredituara në vendin tonë, nxënësit e shkollës teknike amerikane që vinin për të blerë, intelektualë që kishin përfunduar studimet në Francë, Austri, Itali, Rumania, Gjermani.

Ishin intelektualë të profesioneve të ndryshme si, ekonomistë, doktorë, inxhinierë, profesorë të gjimnazëve të Tiranës, të Shkodrës, të Liceut të Korçës, të Gjinnazit të Gjirokastrës, të Shkollës Tregtare të Vlorës, të Shkollës Bujqësore të Golemit, të Normales së Elbasanit. Po kështu vinte edhe një shtresë e pasur e shoqërisë shqiptare, relativisht e vogël, për të blerë aparate fotografike dhe stilografë të firmës amerikane. Të gjithë kur vinin kishin për qëllim për të blerë dhe kur nuk e gjenin atë që donin, pronari e porosiste qoftë librin, revistën apo fjalorin. Kryesisht interesi ishte për "Larouss"-ët dhe fjalorët dygjuhësh.

**Ju ruanti ende sot shumë relike e botime të vjetra nga botimet "Argus". Na tregoni pakëz histori për secilën prej tyre?**

Në 1932 a më 1933, menjëherë pas hapjes së librarisë "Argus", Harri Fullci i dhuron Dhimitër Cancos një fjalor të botuar nga Shtëpia Botuese Hasheti, që daton më 1895. Këtë botim të rrallë e kemi ende në shtëpi.

Libraria "Argus" ka pasur një korrespondencë të suksesshme jo vetëm me Hashetin, por edhe me firmat italiane "Dita Peroni" etj., po kështu edhe me firmën italiane të qeramikës artistike "Marostica".

Në librarinë "Argus", krahas librave artistikë kishte edhe revista të arkitekturës, revista të modës italiane dhe franceze, libra me poezi të poetëve francezë e italianë. Dua të kujtoj pak që gazeta "Shqipëria e Re", organ popullor kombëtar që botohej në Konstancë, me pronar Mihal Xoxën dhe kryeredaktor Gjergj Bubani, vinte në Shqipëri dhe shitej. Duhet shënuar që, në librarinë "Argus" krahas këtyre që përmendëm më lart, shiteshin edhe fjalorët "Petit Roberts" në frëngjisht, "Xingareli" në italisht, "Petit Larousse illustré" në frëngjisht, dhe ajo që kam dëshirë ta përmend edhe një herë, që ka mbërritur si dhuratë, në dy gjuhët frëngjisht dhe anglisht, dhuruar nga Harri Fullci, botuar nga Hasheti më 1895.

**Por ju ruani edhe një tjetër relike të veçantë trashëguar nga xhaxhai juaj, një flamur amerikan të 1945. Cila është historia e tij?**


Mund të jetë një rast unik në Ballkan. Para se të vdiste Dhimitër Cancos bëri një testament dhe secilit prej nesh, na ndau nga një pjesë. Mua më ra për pjesë senduku i Dhimitrit. Pasi e hapa sendukun, i cili kishte kohë që nuk ishte hapur, shikoj që aty ishte flamuri amerikan. Ishte një format i vogël, prej letre.

Nga ç'mesova, në vitin 1945 Jugosllavia, Anglia dhe Rusia ishin në një grup dhe në këtë kohë në Shqipëri u bënë flamur të këtyre shteteve. Dhe Dhimitri e ruajti flamurin amerikan nga viti 1945 deri më 1990. Mu duk shumë e çuditshme si e kishte ruajtur për kaq e kaq vite. Ishte me të vërtetë një trimëri shumë e madhe për kohën. Në atë kohë flamuri amerikan kishte 48 yje siç mund ta shihni edhe ju në foto, ndërsa tani ka 52 yje. Kjo besoj e tregon qartë se miqësia me Harri Fullcin i kishte lënë shumë mbresa Dhimitrit.

(Vijon nesër)

**NË PJESËN E DYTË TË INTERVISTËS DOTË LEXONI:**

Si depërtuan idetë komuniste në Tiranë e viteve 30 përmes librarisë Argus, pse e trazoi Musa Jukën libri me idetë marksiste, botuar në Francë për 50 vjetorin e Marksit, që nisi të shitej në librarinë Argus, aktiviteti i Dhimitër Cancos në ndihmë të komunistëve gjatë luftës dhe si u përndoq pas vendosjes së regjimit komunist për shkak të miqësisë së tij me Harry Fultz-in



Korrespondence e librarise argus me furnisuesit e saj ne europe mes tyre edhe em hashetin ne france

"Laboremus"-it festohej në ditën e madhe të shqiptarizmit, që është 28 nëntori. Revista, me format të madh, që shpesh shkonte deri në 20 faqe dhe nganjëherë edhe më shumë, dilte dy herë në muaj, në shqip dhe në anglisht. Përveç numrave të rregullt dilnin edhe numra speciale, përveç të tjerave, botohej lëndë e ndryshme nga jeta në tërë vitet e shkollës. "Laboremus"-i përgatitej nga një bord prej 8-9 nxënësish dhe një mësues kujdestar. Këshilli botimesi kujdesej për botimin e revistës. Merrej me redaktimin e materialeve që do të botoheshin. Të gjithë nxënësit e shkollës, edhe ata që e kishin marrë diplomën, ishin miq të "Laboremus"-it. Ishte pikërisht kjo revistë prestigjioze që gjente hapësirë për t'i bërë reklamë librarisë "Argus", në një nga numrat e saj.

**Na e përshkruani pak aktivitetin e kësaj librarie?**

Libraria e filloi aktivitetin e saj, siç e thamë, në vitin 1930 dhe e vazhdoi deri në vitin 1952. Është një periudhë 20-vjeçare. Ka pasur një aktivitet të suksesshëm gjatë kësaj kohe. Libraria "Argus" ishte në qendër të Tiranës, karshi ishte pazari i vjetër që vazhonte edhe majtas edhe djathtas dhe atje ishte një dyqan i marrë nga një

**Laboremus" që përgatitej nga nxënësit e shkollës teknike apo jo?**

Ajo u pagëzua me këtë emër nga nxënësit e kësaj shkolle, me emrin kuptimplotë për shkollën latinishte, që në shqip do të thotë "Le të punojmë" - "Laboremus".

Numri i parë i revistës, jo rastësisht doli më 28 nëntor 1924. Dhe, siç dëshmohej, çdo vit më vonë, datëlindja e

Revista Laboremus e nxensve te Harry Fultz ku reklamohet libraria Argus



Dhimiter Canco para librarise Argus Tirane 1940

Po, ju e patë revistën "Laboremus". Aty për herë të parë përmendet fjala "kupon" në Shqipëri. Ishte viti 1932. Në njëri prej reklamave të revistës shënohet: "Shkoni blini në librarinë "Argus" sendet e nevojshme shkollore, që janë të lira, letra shkrimi dhe sende të tjera të nevojshme që u duhen nxënësve për në shkollë, me çmime të arsyeshme, edhe me një zbritje prej 10% të cilën e përfiton përmes këtij kuponi"...

**Pranë librarinë Argus nuk shiteshin vetëm libra por edhe mjete mësimore?**

Po në librarinë "Argus" shiteshin gazeta, revista, libra, fjalorë, gramatika dhe libra të tjerë të çdo lloji në gjuhët frëngjisht, anglisht dhe italisht.

**Reklamën që ju përmendët pak më lart publikohej në revistën "Lab-**



# DOPOLAVORO", PJESA "E PAEKSPOZUAR" E FASHIZMIT SHQIPTAR!

**Si u shërbente të rinjve si një mundësi emancipuese në një vend ku prapambetja vijonte të ishte një problem madhor për pushtetin e radhës...**

NGA **ARMAND PLAKA**

**A**rgëtimi apo kalimi i organizuar i kohës së lirë, që njihet me emërtimin DOPOLAVORO (Paspuna), përkrah "Djelmënisë së Liktorit", "Fashove Femnore" e "Grupeve të Fashistëve Universitare", ishte përcaktuar në statusin e Partisë Fashiste Shqiptare, si pjesë e organizatave që valeshin prej saj.

Një nga ndërtesat më potente e simbolike që u ngritën për t'i shërbyer këtij qëllimi, ishte dhe ndërtesa e DOPOLAVORO-s, ( sot Universiteti i Arteve) në Tiranë, ndërsa ndërtesa të tjera me përmasa më të vogla nisën të shiheshin në atë kohë ngado nëpër Shqipëri.

Nëse flet me dëshmitarët e paktë të mbetur të asaj kohe, apo nëse konsultohesh me materialet arkivore e fotot e kohës, duket se DOPOLAVORO ishte bërë tashmë shumë e njohur në radhët e rinisë shqiptare. Përtej propagandës ajo shërbente edhe si një mundësi e madhe emancipuese në një vend ku prapambetja vijonte të ishte një problem madhor për pushtetin e radhës.

Në këtë kuadër, na shfaqet edhe kjo foto marrë nga Arkiva e Institutit LUCE, që shfaq shumë qartë përveçse anëtarë të Partisë Fashiste Shqiptare dhe "kolegëve" të tyre italianë, edhe eksponentë të Wehrmacht-it gjerman pas një vizite që ata kryen në Tiranë në shtator 1940, duke pozuar në hyrjen e njëjës prej qendrave, ( Duka e Abrucos) apo Selisë së Përkohshme të DOPOLAVORO-s në Rrugën "F. Jacomoni" në Tiranë, ku shihet gjithashtu qartë edhe afishimi i organit zyrtar të shtypit të Partisë Fashiste Shqiptare, "Lajme nga Tirana" që botohej në italisht dhe në shqip.

Fotoja tjetër është marrë nga koleksioni i të dërguarit të Rajhut në Tiranë, Erich von Luckwald, thajse një vit më pas, kur ndërtimi i selisë qendrore të DOPOLAVORO-s, tashmë kishte marrë udhë.

Në veprimtaritë e vatrave apo shtëpive të kulturës, që mbinë më pas në epokën komuniste në Shqipëri, nga DOPOLAVORO-t kishte aplikim të elementëve të ngjashëm në aspektin propagandistik e organizativ, por sigurisht se në shumë aspekte të tjera, nuk donin, nuk mundën dhe nuk ia dolën të kapnin dot nivelin e atyre, të cilat brenda një harku kohor shumë të shkurtër, ishin bërë tashmë shumë të famshme në mbarë Shqipërinë për mundësitë dhe atmosferën që ofronin.

**FOTO 1:** 6 shtator 1940- Hierarkë të Partisë Fashiste Shqiptare dhe asaj italiane, duke shoqëruar eksponentë të Wehrmacht-it gjerman pas një vizite që ata kryen në Tiranë, duke pozuar në hyrjen e njëjës prej qendrave, ( Duka e Abrucos) apo Selisë së Përkohshme të DOPOLAVORO-s në Rrugën "F. Jacomoni" në Tiranë. Marrë nga Arkiva e Institutit LUCE.

**FOTO 2:** Foto si pjesë e koleksionit të të dërguarit të Rajhut në Tiranë, Erich von Luckwald, ne vitin 1941, shfaq ndërtimin e Selisë Qendrore të DOPOLAVORO-s në Tiranë, sot godina e Universitetit të Arteve.

**FOTO 3:** Foto si pjesë e koleksionit të të dërguarit të Rajhut në Tiranë, Erich von Luckwald, ne vitin 1941, shfaq ndërtimin e Selisë Qendrore të DOPOLAVORO-s në Tiranë, sot godina e Universitetit të Arteve.

**FOTO 4:** 19 prill 1940- Faksimile e organit zyrtar të shtypit të Partisë Fashiste Shqiptare, "Lajme nga Tirana" që botohej në italisht dhe në shqip. Armand PLAKA- © Të gjitha të drejtat të rezervuara



# Pritshmëri e lartë nga Samiti i Triestes BE-Ballkani Perëndimor

## A do të ketë një "Plan Marshall" të ri për aspirantët e aderimit në Union?

Samiti i Ballkanit Perëndimor 2017 do të zhvillohet sot në Trieste të Italisë. Samiti do të shërbejë si një rast i rëndësishëm për të punuar së bashku në forcimin e mundësive konkrete duke nxitur bashkëpunimin rajonal me qëllim të zhvillimit të shoqërive gjithëpërfshirëse, qeverisjes së mirë dhe ekonomive vibrante, duke avancuar më tej perspektivën e integritimit të Bashkimit Evropian në rajon.

Federica Mogherini, Përfaqësuese e Lartë e Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politika të Sigurisë/Nënkrjetare e Komisionit, Johannes Hahn Komisioneri për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatave të Zgjerimit dhe Violeta Bulc, Komisionere për Transport do të marrin pjesë së bashku me shefat e Qeverive, Ministrat e Ekonomisë dhe Ministrat e Transportit të Ballkanit Perëndimor dhe homologët e tyre nga gjashtë shtete anëtare të BE-së (Austria, Kroacia, Franca, Gjermania, Italia dhe Sllovenia).

Diskutimet do të fokusohen në tri fusha kryesore të bashkëpunimit rajonal: 1) Lidhshmëria, 2) Integrimi rajonal ekonomik/zhvillimi i sektorit privat dhe 3) Kontaktet mes njerëzve.

Në fushën e lidhshmërisë,

fokusi do të jetë në implementimin e Agjendës së Lidhshmërisë, e cila synon krijimin e kushteve për rritje ekonomike dhe marrëdhënie të mira fqinjësore, në veçanti përmes përgatitjes dhe financimit të projekteve konkrete të investimeve në infrastrukturë rajonale në sektorët e transportit dhe energjisë. Gjatë Samitit, Komisioni Evropian do të prezantojë fonde të reja të konsiderueshme si pjesë e "pakos vjetore të lidhshmërisë". Për më tepër, partnerët e Ballkanit Perëndimor pritet të nënshkruajnë Traktatin e Komunitetit të Transportit, i cili do të ndihmojë në integrimin e rrjeteve të transportit

në rajon dhe me BE-në dhe do të udhëheqë masat reformuese në sektorin e transportit.

Në lidhje me integrimin ekonomik rajonal, partnerët e Ballkanit Perëndimor pritet të bien dakord mbi një plan veprimi për të zhvilluar një Zonë Ekonomike Rajonale me qëllim të rritjes së tërheqjes të rajonit për të rritur investimet dhe për të gjeneruar vende pune, veçanërisht nëpërmjet rritjes së zgjuar, bizneseve të reja dhe rritjes së kapacitetit. Për herë të parë në kuadër të procesit të Berlinit, pjesë e planit të veprimit është edhe një dimension digjital: kjo do të kontribuojë në integrimin e rajonit në tregun

digjital panevropian. Forumi i Investimeve të Odës së Ballkanit Perëndimor, i cili mbledh odat e tregtisë së rajonit, do të inaugurojë Sekretariatit e Përhershëm në Trieste në marginat e Samitit: përfshirja e komunitetit të biznesit do të kontribuojë në kthimin e Zonës Ekonomike Rajonale në mundësi konkrete për kompanitë në rajon. Për zhvillimin e sektorit privat, Komisioni do të rrisë mbështetjen e tij ekzistuese për NVM-të përmes një kontributi të ri në programin e zhvillimit të ndërmarrjeve dhe inovacionit për Ballkanin Perëndimor si dhe në nxitjen e investimeve më dinamike.



Sa i përket kontakteve mes njerëzve, Komisioni Evropian së bashku me qeverinë italiane është duke organizuar një forum rinor të BE-Ballkanit Perëndimor në marginat e Samitit për të vlerësuar rezultatet e arritura që nga viti i kaluar dhe për të eksploruar fusha të tjera të bashkëpunimit. Përfundimet e forumit të të rinjve do të prezantohen gjatë Samitit. Forumi dhe Samiti do të shërbejnë gjithashtu për të nxitur pjesëmarrjen në programin e shkëmbimit Erasmus, i cili feston përvjetorin e tij të 30-të këtë vit dhe është zgjeruar me sukses në Ballkanin Perëndimor. Bazuar në rezultatet e forumit të të rinjve,

Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor (RYCO) do të zhvillojë më tej programin e saj të punës për të nxitur bashkëpunimin midis të rinjve të rajonit. Gjatë Samitit, liderët politikë pritet të rikonfirmojnë angazhimin e tyre ndaj një skeme shkëmbimi për shërbyesit e rinj civilë nga rajoni, e cila u lansua në Samitin e Ballkanit Perëndimor të vitit të kaluar në Paris dhe ka treguar rezultate shumë pozitive. Italia është nikoqire e Samitit të katërt vjetor në kuadër të "Procesit të Berlinit", një iniciativë për bashkëpunim rajonal në Ballkanin Perëndimor, e cila pason pas Samiteve në Berlin (2014), Vjenë (2015) dhe Paris (2016).

# Samiti në Trieste, Ballkani Perëndimor në dhomën e pritjes

Edhe Ballkanit Perëndimor ndodhet në Bashkimin Evropian - këtë fjalë e kanë nënshkruar krerët e shteteve dhe qeverive europiane në vitin 2003. Premtimi i njohur i Selanikut tingëllon sot kaq i mjegullt, si mitet greke. Sepse që atëherë në BE është pranuar vetëm Kroacia. Me ndarjen e Kosovës nga Serbia u krijua një problematikë e re në rajon. Zgjerim? Askush nuk po e përdor më këtë fjalë. "Zgjerimi është një si pulë që i është prerë koka", tha një diplomat serb kundrejt platformës BuzzFeed. "Ajo rend ende, por në të vërtetë është duke ngrohur." Për Eric Gordy nga "London University College", premtimi u dha në mënyrë taktike për të ruajtur influencën e BE në Ballkan. Në të gjithë këto vite në Shqipëri, Kosovë, Serbi, Bosnje, Mali i Zi apo Maqedoni në pushtet kanë qenë elita, të cilat të paktën në mënyrë formale duan t'i çojnë vendet e tyre drejt BE-së. "Veçse taktika nuk po zë më vend. Gjithnjë e më shumë ka zëra që janë kundër zgjerimit. Prandaj për të ruajtur influencën e saj, BE duhet të ofrojë një perspektivë realiste", thotë Gordy për DW.

## JO LËSHIME

Rënia e ndikimit të perëndimit duhet të gëzojë vende si Rusia, Turqia por edhe Kina e vendet e gadishullit arabik. Diplomatat e BE përpiqen që

t'i dalin kundër kësaj retorike. "Ne duam t'i çojmë këto vende drejt BE", thotë Christian Hellbach, koordinator i posaçëm për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Jashtme në intervistë me Deutsche Wellen. "Por nuk është sekret, që afrimi me BE po ecën shumë ngadalë, sepse jo të gjithë aktorët kanë interes për reforma të qëndrueshme."

Një formulë diplomatike e dëgjuar përditë në Ballkan: Në çështjet e shtetit ligjor, të drejtat e njeriut, luftën kundër korrupsionit nuk do të ketë lëshime. Gjendja në vendet e Ballkanit i jep Christian Hellbachut të drejtë: Shumë vetë kanë probleme me mungesën e pavarësisë së gjyqësorit, mediat mbahen nën kontroll dhe buxheti shtetëror kuptohet si kuletë e partisë qeverisëse. Kësaj i shtohen pengesa dukshme të pakapërcyeshme si grindja mes Prishtinës dhe Beogradit, problemet e pazgjidhura të Maqedonisë me Greqinë për shkak të emrit, mungesa e gatishmërisë së tre etnive në Bosnje që të bien dakord për një reformë kushtetuese. Me BE po negocion për anëtarësim vetëm Serbia dhe Mali i Zi, Kosova dhe Bosnja as nuk janë kandidatë zyrtarë. Profesor Gordy është skeptik që kjo gjendje do të ndryshojë. Për shkak se prijësat e Ballkanit nuk e dorëzojnë me dëshirë pushtetin e tyre, ka dy opsione: Të presësh përjetësisht në dhomën e pritjes së BE, ose të shpresosh në një kompromis, ku Brukseli të hapë derën, megjithëse

krerët nuk janë përbushur. "Këtë e ka bërë njëherë BE", thotë Eric Gordy. Bullgaria dhe Rumania janë ende oaze korrupsioni, Qiproja u pranua pa zgjidhjen e problemit të kufijve. Por sot këto pranime janë si sinjale alarmi për BE që nuk do probleme.

## RËNIA E ENTUZIAZMIT - NGA TË DY KRAHËT

BE aktualisht është më shumë e zënë me veten, me krizën financiare, me refugjatët, Brexit, me aktin e balancimit të vazhdueshëm mes Trumpit dhe Putinit. "Për momentin nuk e kam mendjek tek zgjerimi", është

**Berlini e vë shpresën tek joshja ekonomike e BE-së, që ende është e fuqishme. Tani flitet për një union doganor dhe treg të përbashkët të 6 vendeve të Ballkanit, ndërsa para pak muajsh edhe për një plan "Berlin plus"**

shprehur kreu i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker në vitin 2012, që parë nga zhvillimet e sotme mund të shihet si kohë e artë për BE. Edhe në Gjermani sondazhet e vjeshtës së shkuar tregojnë, se dy të tretat e popullsisë nuk duan për një kohë të pacaktuar pranime të reja në BE. "BE është në atë gjendje, që po të donte vetë të hynte në union do të kishte probleme në përbushjen e kritereve", kritikon Sevim Dagdelen, deputete e partisë së Majtë në Bundestag. Shumë vetë e përjetojnë BE si një makineri e grirjes së sistemit social" e nuk kanë besim më në premtimin për mirëqenie.

Kjo lodhje e BE me zgjerimin ka mbërritur natyrisht edhe në vendet e Ballkanit. Ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić është shprehur se pa një plan konkret, qytetarët e humbasin besimin. "Kjo nuk është e mirë as për BE dhe as ne." Kështu entuziazmi për Bashkimin Evropian bie dita-ditës. Në Universitetin e Beogradit në qershor një shumicë studentësh ka folur kundër anëtarësimit në BE. Gordy analizon: "Karta e fundit që kishte BE ishte garancia e pakthyeshmërisë së reformave demokratike." Edhe kjo po zhbëhet, për shkak të reagimit të dobët ndaj qeverive autoritare në Poloni dhe Hungari.

## "PLAN MARSHALL" PËR BALLKANIN?

Sidomos Berlini e vë shpresën tek

joshja ekonomike e BE-së, që ende është e fuqishme. Tani flitet për një union doganor dhe treg të përbashkët të 6 vendeve të Ballkanit, ndërsa para pak muajsh edhe për një plan "Berlin plus", plan gjerman, që me paratë e BE-së të financohen projekte të mëdha në infrastrukturë. Një shembull pararojë ndoshta autostrada që do të lidhë Shqipërinë, Kosovën dhe Serbinë. "Po qe se i mbështesim projekte të tilla, atëherë njerëzit vënë re se gjërat lëvizin", thotë Hellbach. Plani me emërtimin optimist "Marshall" për Ballkanin do të jetë temë diskutimi edhe në Trieste. Megjithatë nuk dihet, se nga cilat burime BE do të vijnë fondet. Pushtetarët në Ballkan do të duhej të gëzoheshin për lumin e parave, ministri i Jashtëm i Malit të Zi, Srdan Darmanović ka dyshime: "Asnjë model bashkëpunimi nuk duhet të çojë në ngadalësimin e politikës së zgjerimit apo të jetë një zëvendësim për këtë." Për njerëzit në Ballkan pritja në dhomën e pasme të BE do të thotë luftë për mbijetesë. Kuotën e papunësisë nga 15-30% shumë e shohin të zburuar, ndërsa një rrogë 360-500 euro është realitet shpesh për ata që kanë tesserën e duhur të partisë. Mijëra të rinj të kualifikuar lenë vendin drejt Europës. Një gjendje ironike e shprehur me cinizëm në një tweet: "Ne do të anëtarësohemi në BE, por shkallë-shkallë - çdo vit me nga 20.000 vetë."

(Koment i radios gjermane "Deutsche Welle")

# Hidhet shorti i Superiores Shulku: Gara nis në 9 shtator

"Shpresojmë që ky kampionat të ketë garë dhe rivalitet"



Ilir Shulku

Është hedhur në Federatën Shqiptare të Futbollit, shorti për edicionin e ardhshëm të Kategorisë Superiore 2017-2018. Nën interesimin e përfaqësuesve të klubeve që do të marrin pjesë në këtë kampionat dhe të mediave, skuadrat e Superiores kanë mësuar për datat dhe se kur do të ndeshen me kundërshtarët e tyre. Kampionati nis menjëherë me përballje për titullin, pasi ekipet pretendente do të ndeshen që në javën e dytë, ndryshe nga edicioni i kaluar. Në javën e dytë të Superiores luhet dueli Partizani-Kukësi, në të tretën do të luhet dueli Skënderbeu-Partizani dhe në të katërtën Kukësi-Skënderbeu. Shorti është hedhur nga Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit Ilir Shulku dhe Shefi i Departamentit të Garave Lysien Nurishmi. Java 1; Partizani-Laçi, Kukësi-Kamza, Skënderbeu-Flamurtari, Lushnja-Vllaznia dhe Teuta-Luftëtari. Kampionati do të nisë në datë 9 shtator. Një datë e pazakontë për të filluar edicionin, që duhet të mbyllet në mesin e muajit maj për shkak të kampionatit botëror që luhet në Rusi verën e ardhshme. Sekretari i FSHF Ilir Shulku tregon se ky është një vendim pas kërkesës së bërë nga shumica e klubeve të superiores. "Para se të hidhet shorti klubet janë informuar për datën që mund të fillonte kampionati dhe shumica e tyre kanë kërkuar që sezoni të fillojë më datë 9 shtator. Më datë 6 do të lu-

het superkupa e Shqipërisë. Mendoj se përveç Kamzës që po rinovon stadiumit dhe Lushnja që do të nisë punimet ekipet e tjera e kanë

infrastrukturën. Shpresojmë që ky kampionat të ketë garë dhe rivalitet si edicionet e kaluara. Është mirëmenduar edhe kalendari, kampionati ka

edo muaj 4 deri në 5 ndeshje, nga shtatori deri në dhjetor. Nuk besoj që ka ngjeshje të ndeshjeve dhe është mëse normale" deklaroi ai.

## MERKATO

### Rodriguez lë Realin transferohet te Bajerni i Mynihut

Bajerni i Mynihut ka realizuar goditjen e madhe në merkato duke rrëmbyer kolumbianin James Rodriguez nga Reali i Madridit. 25-vjeçari i bashkohet zyrtarisht Bajernit të Mynihut në formën e huazimit për 2 vite, ndërsa më pas gjermanët kanë mundësinë e blerjes së kartonit për 35.2 mln euro, por jo detyrimisht. Ndërsa për dy vitet e huazimit Bajerni do derdhë në arkën e Realit

të Madridit 10 milionë euro, ndërsa nëse e blen përfundimisht në 2020, James do t'i kushtojë Bajernit 60 milionë euro. Largimi i James nga Reali ishte i sigurt, pasi edicionin që kaloi nuk gjeri hapësira në formacionin e Zidane, por kalimi te Bajern ishte surprizë, pasi pritej që të zhvendosej në Angli. Por, vendimtar ka qenë tekniku Ancelotti në këtë lëvizje, pasi i njeh mjaft mirë cilësitë e kolumbianit.



James Rodriguez

## ZYRTARE

### Donnarumma firmos rinovimin me Milanin



Merr fund telenovela, Donnarumma firmos me Milanin deri në 2021. Pas një takimi rreth tre orë, portieri u bind që të firmoste zgjatjen e kontratës, ndërsa do të përfitojë 6 milionë euro në sezon.

Por, nëse Milani nuk do të arrijë të kualifikohet për në Champions League sezonin e

ardhshëm, klauzola e largimit të portierit do të jetë 50 milionë euro, por nëse kuqezinjët do të luajnë Europa League klauzola shkon 100 milionë. Por duket se për tërheqjen Donnarumma kishte dhe një kusht, që u plotësua, pasi vëllai i tij Antonio Donnarumma u bë pjesë e Milanit, pasi u ble nga Asteras Tripolis.

## Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

### LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Ndryshojnë ministrinë, Rama: Qeveria e re do rristrukturohet
- Berisha në sulm, lëvizje për shpëtimin e Lulzim Bashës
- "Si i fshehu Vehbi Alimuça në Hungari paratë e shqiptarëve"
- OSBE-PE përplasen për Shqipërinë Kukan: Duhet të hapen negociatat
- Thembra të plasuritura? Ja receta pa shpenzime që zhdok problemin
- Të dashuruar pas kafes? Pas këtij lajmi do ta doni edhe më shumë
- 'Xibraka', 104 vite burg për Bandën, 10 për nipin e Enverit
- Dëshmpërblimi/Ja emrat e 162 pronarëve që marrin 5 milionë €
- Këlliqi:Pse më la Basha jashtë liste pata ofertë nga një tjetër parti
- "E majta po qeveris, por LSI-PD në pushtet" Ja si përgjigjet Rama

### LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Kryesia e LSI, Kryemadhi: Zgjedhjet u manipuluan
- Berisha në sulm, lëvizje për shpëtimin e Lulzim Bashës
- Xhafaj si ministër: Vetting në polici, ndryshime në drejtori
- Topalli ankohe te zyrtarët e CDU: Basha rëno PD-në
- 'Xibraka', 104 vite burg për Bandën, 10 për nipin e Enverit

### VIDEOT MË TË KLIKUARA

Zbulohet Idrizi, numri i votave më pak se procesverbalet



Moti për datën 10.07.2017 dhe ditët në vazhdim

Turqi, Rama: Shqipëria mund të bëhet front i ri i naftës në botë




Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

## SONDAZHI I DITES

Ku do i kaloni pushimet e verës?

### Rezultati i Sondazhit



#### SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



1.592 | 333 768  
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE



# VENDE UNIKE PËR TË VIZITUAR! THE MOST UNIQUE PLACES TO VISIT!



## BUNK'ART 1

- Ekspozita video-muzeale e periudhës së komunizmit në Shqipëri e ndërtuar brenda bunkerit anti-bërthamor të Luftës së Ftohtë

- The video-museum exhibition of Albania's communist era build inside the anti-nuclear bunker of the Cold War




## BUNK'ART 2

- Ekspozita e parë video-muzeale e ndërtuar në kujtim të viktimave të terrorit komunist

- The first video-museum exhibition built in memory of the victims of the communist terror



**Ku ndodhet BUNK'ART 1?**  
Rr. Fadil Deliu  
(afër teleferikut) - Tiranë



**Ku ndodhet BUNK'ART 2?**  
Rr. Abdi Toptani  
(përballë Bashkisë) - Tiranë

[www.bunkart.al](http://www.bunkart.al) / [info@bunkart.al](mailto:info@bunkart.al)

**Prenotime / Reservations:**

**+355 (0) 67 20 72 905**

